



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
INSTITUTI I SIGURISË USHQIMORE DHE VETERINARISË

Tiranë më, 23.12.2021

Raporti i Analizës Vjetore ISUV 2021

Mbi aktivitetin analitik të Laboratorëve Testues (LT) të ISUV.

Verifikuar nga:

Dr. Armand REVELI; I ngarkuar me detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm; ISUV

TIRANË

Përmbatja	
Hyrje	4
Departamenti i Menaxhimit të Cilësisë dhe Shërbimeve.....	Error! Bookmark not defined.
ÇËSHTJA Nr. 1 AKTIVITETI I DEPARTAMENTIT	Error! Bookmark not defined.
ARRITJA E OBJEKTIVAVE TË DEPARTAMENTIT	Error! Bookmark not defined.
Objektivi 1. Ruajtja e Akreditimeve	Error! Bookmark not defined.
Objektivi 4. Hartimi dhe rishikimi i dokumentacionit të Cilësisë	Error! Bookmark not defined.
Objektivi 5. Zgjerimi i Akreditimit.....	Error! Bookmark not defined.
Objektivi 6. Hartimi dhe zbatimi i planit vjetor të mirëmbajtjes së pajisjeve	Error! Bookmark not defined.
Objektivi 7. Realizimi i prodhimit të terreneve kulturave në kohë dhe cilësi.	Error! Bookmark not defined.
Objektivi 8. Menaxhimi i Kampioneve sipas Procedurave në fuqi.	Error! Bookmark not defined.
Objektivi 9. Menaxhimi i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse	Error! Bookmark not defined.
ÇËSHTJA NR. 2 PROPOZIME PËR PËRMIRËSIM REFERUAR PROBLEMATIKAVE TË NDESHURA	Error! Bookmark not defined.
Departamentit të Mikrobiologjisë, Monitorimit të Ujërave dhe Cilësisë	Error! Bookmark not defined.
Përmbledhje e DMMUC	Error! Bookmark not defined.
Realizimi I Kontrolleve Zyrtare me bazë risku AKU	Error! Bookmark not defined.
Realizimi i objektivave 2021	Error! Bookmark not defined.
Objektiva per 2022 DMMUC	Error! Bookmark not defined.
DSHK.....	Error! Bookmark not defined.
Përmbledhje e DSHK.....	Error! Bookmark not defined.
Bashkëpunimi me projekte ndërkombëtare	Error! Bookmark not defined.

Objektivat për 2022 DSHK.....	Error! Bookmark not defined.
PROBLEMATIKA E HASURA	Error! Bookmark not defined.
DSHMB	Error! Bookmark not defined.
Hyrje	Error! Bookmark not defined.
Aktiviteti analitik si dh etekniko-shkencore per vitin 2021 ka perfshirë:.....	Error!
Bookmark not defined.	
Sektori i Shendetit te Bimeve	37
Problematikat lidhur me kete Sektor.....	
DTMMKB.....	
Sektori I Toksikologjisë dhe Mbetjeve (STM)	Error! Bookmark not defined.
Aktivitetet analitike.....	Error! Bookmark not defined.
Analizat zyrtare	Error! Bookmark not defined.
Realizimi i PKM Mbetje.....	Error! Bookmark not defined.
Realizimi I Kontrolleve Zyrtare me bazë risku AKU	Error! Bookmark not defined.
Sektorit të Kontrollit të Barnave Veterinare (SKBV).....	Error! Bookmark not defined.
Aktiviteti i Sektorit per Vitin 2019:	Error! Bookmark not defined.
Aneksi 1	Error! Bookmark not defined.

Hyrje

Ky dokument, paraqet analizën e punës së Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe të Veterinarisë (ISUV) për vitin 2020.

Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV) kontribuon me aktivitetin e tij në fushën e sigurisë ushqimore, shëndetit të kafshëve dhe shëndetit e mbrojtjen e bimëve. Raporti paraqet/analizon punën e kryer dhe jep statusin aktual të institucionit lidhur me: kapacitetet e tij teknike, financiare, burimet njerëzore, rezultatet e aktivitetit analitik, si dhe shkallën e realizimit të objektivave të tij të zhvillimit. Vëmendje i është kushtuar edhe identifikimit të problematikave që kanë ndikuar në realizimin e punës së planifikuar

Gjithashtu stafi është përkushtuar këtë vit që të zgjerojë gamën e shërbimeve duke validuar/akredituar metoda të reja. Aplikimi i këtyre metodave është jetësore për ISUV-në në mënyrë që Shëndeti dhe Mirëqënia e Kafshëve/ Siguria Ushqimore të jenë në përputhje me rregulloret e BE-së, Rekomandimet e FVO-së dhe Legjislacionit Shqiptar. Informacioni më i detajuar mbi zhvillimin, validimin e metodave, akreditimin apo dhe i aktiviteteve të tjera gjëndet i shpjeguar në mënyrë më të detajuar në nivel të Departamenteve Analitike të ISUV-së, sa më poshtë vijon.

Në këtë kontekst gjatë vitit 2021 Laboratorët e ISUV-së kanë arritur të rimarrin akreditimin për 96 shërbime të akredituara duke bërë që laboratorët tanë të ruajnë kompetencën teknike të stafit dhe besueshmërisë së rezultateve, si një nga rekomandimet e Kap.12 të Bashkimit Europian. Gjithashtu kemi arritur të përmbysim përmirësimin e infrastrukturës laboratorike në fushën e mbetjeve si një nga komponentet më të rëndësishme lidhur kjo me kërkesat në rritje të akreditimit si dhe plotësimit të kushteve për biosafety dhe biosecurity.

Raport vjetor DMMUC 2021

Mbi aktivitetin analitik të Laboratorëve Testues (LT) të Departamentit të Mikrobiologjisë, Monitorimit të Ujërave dhe Cilësisë (DMMUC).

Përgatitur nga :

Erlinda Buhaljoti; Drerjtor; Departamenti I Mikrobiologjisë, Monitorimit të Ujërave dhe Cilësisë (DMMUC)

Marsela Korçari; Përgjegjëse; Sektori i Produkteve të Peshkut dhe Monitorimit të Molusqeve (SPPMM), ISUV

Renis Maçi; Përgjegjës; Sektori i Kontrollit Mikrobiologjik të Produkteve (SKMP), ISUV

Emil Sharko; Përgjegjës; Sektori i Vlerësimit të Cilësisë së Ushqimeve (SVCU), ISUV

DEPARTAMENTIT TË MIKROBIOLOGJISË, MONITORIMIT TË UJËRAVE DHE CILËSISË (DMMUC)

Departamenti i Mikrobiologjisë, Monitorimit të Ujrave dhe Cilësisë ka drejtuar 13 laboratorë testues të fushave të ndryshme me një staf prej 18 punonjësish.

Ai ka ofruar shërbime të specializuara brenda kuadrit ligjor të laboratorit të referencës në fushën e ekzaminimeve mikrobiologjike, biologjike, kimike dhe të cilësisë së ushqimeve me origjinë shtazore dhe joshtazore si dhe të ushqimeve për kafshë.

Gjatë vitit 2021 laboratorët e DMMUC kanë analizuar në total 3836 kampione me 16651 analiza (Tabela 1).

Tabela 1: Numri i analizave dhe kampioneve analizuar nga laboratorët e DMMUC

	SVCU		SPPMM		SKMU	
	Kampione	Analiza	Kampione	Analiza	Kampione	Analiza
PKM			958	1088	77	154
Zyrtare	120	239	121	1089	677	3893
Autokontroll/Eksport	1363	6775	153	1377	363	2036
Totali	1483	7014	1232	3554	1121	6083

SEKTORI I PRODUKTEVE TË PESHKUT DHE MONITORIMIT TË MOLUSQEVE

Sektori i Produkteve të Peshkut dhe Monitorimit të Molusqeve ka si aktivitet bazë analizimin biologjik dhe kimik të produkteve ujore (molusqeve bivalve, produkteve të peshkimit etj.), si dhe të mjedisit (ujit), ku ato rriten. Një fushë e rëndësishme e punës së sektorit është aspekti teknik dhe shkencor.

Sektori zbaton 5 plane kombëtare të monitorimit molusqeve si më poshtë:

- Planet e kampionimit të zonës së rritjes dhe mbledhjes së molusqeve bivalvë të gjalla, BM1 Lagunën e Butrintit, Ksamil, Sarandë” Nr. 1412 Prot., datë 28/03/2013 dhe Nr. 1587 Prot., datë 7/03/2014;
- Plani i kampionimit të zonës së rritjes dhe mbledhjes së molusqeve bivalvë të gjallë për Gjirin e Shëngjinit, në Lezhë me nr. protokolli 424, datë 16.01.2015;
- Plani i monitorimit të grumbullimit të molusqeve bivalvë të gjallë në zonat natyrale të bregdetit Shqiptar (zonën Karavasta MB5, Shkumbin-Spille MB6, Gjiri i Durrësit BM7 dhe Shëngjin-Velipojë BM8; Urdhërit Nr. prot. 77, Datë 10/01/2017;
- Plani i kampionimit të zonës së rritjes dhe mbledhjes së molusqeve bivalvë të gjallë për Gjirin e Butrintit, në Ksamil, Sarandë, Nr. 9658 Prot., datë 15/12/2015;
- Plani i kampionimit të zonës së rritjes dhe mbledhjes së molusqeve bivalvë të gjallë për Kepi i Rodonit, Deti Adriatik (Nr. 2875/1 Prot., datë 31/07/2018);

Metodat që përdoren në këtë sektor janë metoda zyrtare (me përjashtim të histaminës që është metodë e brendshme), të orientuara sipas Rregulloreve 2074/2005, 2073/2005 të BE-së, 835/2011.

Lista provave të aktivitetit analitik të sektorit Produkteve të Peshkut dhe Monitorimit të Molusqeve:

- ✓ Përcaktimi i TVB-N në produktet e peshkimit (Ref: Official journal of EU 22.12.2005)

- ✓ Percaktimi i acidit domoik ne molusqet bivalvore me HPLC – UV (Ref: AESAN-EURLMB Domoic acid, version 1, 2008).
- ✓ Percaktimi i toksines PSP ne molusqet bivalve (Ref: AOAC official method 959.08 2005)
- ✓ Metoda per vleresimin e sasise dhe perberjes taksonomike te fitoplanktonit (Ref. EN 15204:2006).
- ✓ Percaktimi i algave bentonike/epifitike potencialisht toksike (Ostreopsis spp., Coolia monotis, Prorocentrum lima, Amphidinium spp.) (Ref: EN 15204:2006, Linee guida-Consiglio Superiore di Sanita).
- ✓ Percaktimi I Histamines ne produktet iktike me metoden HPLC-DAD (Ref: AOAC 1996 (Vol 79) -1999 (Vol 82)).

AKTIVITETI LABORATORIK

Gjatë vitit 2021 sektori ka kryer gjithsej 3554 analiza në 1232 mostra (Tab. 1), kampione të ardhur në kuadër të PKM, inspektimeve të AKU-së si dhe kontrollet jozyrtare.

Tabela 1: Rezultatet e mostrave të analizuara sipas kategorive të inspektimit dhe grupmatricave

Kategoritë e analizave	Grup-matricë	Nr. i mostrave	Nr. i mostrave mbi normë	Nr. i analizave
Mostra për planet e monitorimit të molusqeve	Molusk bivalvor	130		260
	Ujë lagune/deti	480		480
	Gërryerje bentonike	303		303
Mostra për planin e produkteve peshkore	Produkte iktike të papërpunuar dhe të përpunuara	45		45
Totali i PKM-së:		958		1088
Mostra të inspektimit të AKU-së.	Produkte iktike të papërpunuar dhe të përpunuara	121	1	1089
Totali i AKU-së:		121	1	1089
Totali i kontrollit zyrtar (AKU + PMK):		1079	1	2177
	Produkte iktike të papërpunuar dhe të përpunuara	153	2	1377
Totali i kontrollit jozyrtar:		153	2	1377
TOTALI:		1232	3	3554

Sipas kategorive të kontrollit: janë kryer 2177 (61.3%) analiza zyrtare (AKU+PKM) në 1079 (87.6%) mostra; ndërsa për kontrollin jo zyrtar janë kryer 1377 (38.7%) analiza në 153 (12.4%) mostra. Të dhënat tregojnë se puna e Sektorit në aspektin laboratorik mbështetet më shumë në mostrat e ardhura nga kontrollet zyrtare. Ndërkohë në figurën 1 janë paraqitur numri i analizave në % sipas kategorive të kontrollit, (PKM, AKU dhe Jo zyrtare), ku shihet që pesha më e madhe e analizave këtë vit lidhet me PKM-të, më pas kontrollin jozyrtar dhe inspektimet e AKU-së.

Nga kontrollet zyrtare, analizat në kuadër të planeve përbëjnë 88.7%, kundrejt 11.2% që vijnë nga inspektimet e AKU-së.

Tabela 2: Mostrat dhe analizat e kryera sipas llojit të analizës

Llojet e analizës	Numri i mostrave	Përqindja sipas totalit të mostrave	Numri i analizave	Përqindja sipas totalit të analizave
FP	480	63.5	480	22
AL	303		303	
Lab. i Fitoplanktonit	783		783	
ASP	130	10.5	130	7.3
DSP				
PSP			130	
Lab. i Biotoksinave	130	10.5	260	7.3
HI	274	25.9	2466	70.6
TVB	45		45	
Lab. i Histaminës	319		2511	
Totali	1232	100	3554	100




Fig. 1: Analizat e kryera në përqindje sipas kategorive të kontrollit për vitin 2021

Në treguesin e freskisë të produkteve të peshkimit, për praninë e histaminës gjatë vitit 2021 u konstatuan tre raste positive (Tab. 1), ku një rast ishte kontroll zyrtar, AKU dhe dy raste vetëkontroll. Këto raste u shpallën positive pasi kaluan kufiri ligjor të përcaktuar në rregulloren CE 2073/2005. Përsa I përket kampioneve të tjerë rezultatet kanë qenë konforme. Për sa i përket analizave të biotoksinave për praninë e DSP-së në molusqet bivalvë të gjalla me metodën kimike me LC/MS/MS gjatë vitit 2021 u shtrua metoda.

OBJEKTIVAT

Për vitit 2021, sektori ka realizuar këto objektiva si më poshtë:

1. Mirëmbajtja e akreditimit për 5 teste e akredituara në lidhje me Planeve Kombëtare të Monitorimit të Molusqeve dhe kontrollet zyrtare.
2. Realizimi i Planeve Kombëtare të Monitorimit të Molusqeve. Janë realizuar PKM e Molusqeve dhe të Peshkut për të gjithë kampionet e ardhur në ISUV.
3. Analizimi i kampioneve të ardhur në kuadër të planit me bazë Risku të AKU-së dhe kontrolleve zyrtare si dhe analizat në kuadër të kontrolleve jozyrtare
4. Zhvillimi i metodës kimike për përcaktimin e toksinave të grupit të DSP me LC/MS/MS.

AKTIVITETE TEKNIKO-SHKENCORE DHE AKREDITIMI

AKREDITIMI

Është mirëmbajtur akreditimi për 5 metoda biologjike dhe kimike me trupën Shqipëtare të Akreditimit (DPA). Gjatë vizitës vlerësuese në laboratorët e këtij sektori nuk u gjet asnjë jo konformitet. Gjatë viti 2021 në lidhje me menaxhimin e cilësisë janë rishikuar Proçedura Operative Standarte si dhe Proçedura Menaxhuese Standarte për mbarëvajtjen e punës në sektor. Janë plotësuar të gjithë dokumntacionet në cilësi në lidhje me menaxhimin e aparaturave, ambienteve, monitorimin e temperaturave të frigoriferëve, jo konformiteteve etj.


SEKTORI I VLERËSIMIT TË CILËSISË USHQIMORE

Sektori i Vlerësimit të Cilësisë Ushqimore ka si objekt të punës së tij vlerësimin nga ana cilësore të produkteve agro-ushqimore të importuara apo të prodhuara në vend, për analizimin e treguesve fiziko-kimikë në përputhje me standartet shqipëtare (seria STASH-eve), apo kodeksit ushqimor mbështetur në ligjin e Ushqimit Nr. 9863 dt. 28.01.2008.

AKTIVITETI LABORATORIK

Gjatë vitit 2021 sektori ka analizuar gjithsej 1483 kampione të produkteve të ndryshme ushqimore me një total prej 7014 analiza fiziko kimike (Tab. 3).

Fig. 2: Analizat e kryera gjatë vitit 2021 sipas kategorive të kontrollit



Sipas kategorive të kontrollit: për kontrollet zyrtare (AKU, ekspertiza etj.) janë analizuar **120** kampione ndërsa për autokontrollin dhe eksportet janë analizuar **1363** kampionë.

Sipas laboratorëve të këtij sektori numri i kampionëve të analizuar dhe analizave të kryera paraqitet në tabelën 3.

Tabela 3: Kampionet dhe analizat e kryera sipas laboratoreve përkatës

Laboratorët	Numri i kampioneve			Numri i analizave		
	Total	Kontroll Zyrtar	Autokontroll	Total	Kontroll Zyrtar	Autokontroll
Laboratori i Drithrave	382	53	329	1317	145	1172
Laboratori i Përgjithshëm analitik	100	9	91	344	18	326
Laboratori i Mish-Qumështit	359	12	347	1069	28	1041
Laboratori i Vajrave bimore	40	8	32	240	48	192

Laboratori i konservave bimore	38	38	0	96	0	96
Etiketa	564			3948		
Totali	1483	120	799	7014	239	2827

OBJEKTIVAT

Për vitin 2021, sektori ka realizuar objektivat, si më poshtë:

1. Mirëmbajtja e akreditimit të metodës për përcaktimin e aciditetit të lirë të shprehur si acid oleik në vaj ulliri.
2. Analizimi i kampioneve të ardhur në kuadër të planit me bazë Risku të AKU-së dhe kontrolleve zyrtare.
3. Analizimi i kampioneve të ardhur në kuadër të autokontrollit dhe eksporteve.

AKTIVITETE TEKNIKO-SHKENCORE

AKREDITIMI

Gjatë 2021-ës, SVCU në të gjithë laboratorët e tij ka vazhduar implementimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë, bazuar në ISO 17025. Është plotësuar çdo dokument i menaxhimit të cilësisë. Gjatë 2021 gjithashtu është mirëmbajtur akreditimi i provës kimike lidhur me vajin e ullirit nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit:

- *Përcaktimi i aciditetit të lirë të shprehur si acid oleik në vaj ulliri.*

PJESËMARRJA NË TESTET E ZOTËSISË

Për garantim të cilësisë së rezultateve për provat e tjera objekt validimi/akreditimi, gjatë vitit 2021, specialistët e sektorit kanë marrë pjesë në 1 test zotësie organizuar nga FAPAS, Ent i njohur ndërkombëtarisht për 5 prova analitike:

- Acid Benzoik
- Acid Sorbik
- Acid Citrik
- Grada Brix

- pH

SEKTORI I KONTROLLIT MIKROBIOLOGJIK TË PRODUKTEVE

Sektori i Kontrollit Mikrobiologjik të Produkteve kryen analiza mikrobiologjike bazuar në norma dhe kritere specifike të higjenës së produkteve sipas legjislacionit për sigurinë ushqimore. Ky sektor është pjesë e zbatimit të planeve kombëtare të monitorimit të molusqeve.

AKTIVITETI ANALITIK

Gjatë vitit 2021, në total u analizuan 1121 mostra, nga të cilat 758 kampione (67.6%) janë kampione të pranuar në kuadër të planeve të monitorimit dhe kontrolleve zyrtare, ndërsa, 363 (32.4%) janë kampione të autokontrollit/jozyrtare per eksport.

Gjithësej u kryhen 6083 analiza mikrobiologjike dhe të dhënat më të detajuara sipas llojit të analizës apo kategorisë së kërkuar jepet në tabelën më poshtë. Duke ju referuar kësaj table del se në kuadër të higjenës së produkteve ushqimore janë kryer gjithsej 2591 ndërsa nurmi i analizave të kërkua për patogjenët ushqimor është në vlerën e 3428 analiza.

Tabela 4: Lloji dhe numri i analizave të kryera gjatë vitit 2020 sipas motivit të kampionimit

Motivi i kampionimit	Jo-zyrtare/Eksport	Monitorim	Zyrtare	Zyrtare konfirmim	Sigurimi i Cilesise se te Dhenave	Totali
<i>Salmonella</i>	705	77	1700	5	15	2502
<i>Listeria monocytogenes</i>	95	0	285	20	25	425
Stafilokoke	160	0	335	0	5	500
<i>E.coli</i> ne Pjate	775	0	1265	0	5	2045
<i>E.coli</i> ne tuba	0	77	0	0	0	77
<i>E.coli</i> me filter	51	0	4	0	0	55
Enterobakterie	250	0	110	0	12	372
Ngarkese mezofile	0	0	90	0	7	97
<i>Bacillus cereus</i>	0	0	0	0	9	9
<i>Cronobacter sakazakii</i>	0	0	0	0	1	1
Qeliza somatike	0	0	0	0	0	0
Totali	2036	154	3789	25	79	6083

Zbatimi i planit Kombëtar të Kontrolleve Zyrtare me Bazë Risku për produkte me origjinë shtazore, joshtazore dhe të kontrolleve në PIK është me rëndës për disa parametra të rëndësishëm të sigurisë ushqimore të cilët realizohen në të shumtën e rasteve në këtë Sektor is *Salmonella* spp dhe serovartet e tij, *Listeria monocytogenes*, *Bacillus cereus*, *E. sakazakii*

krahas treguesve të tjerë si indikatorë të higjenës (*E.coli*, Enterobakterie, Stafilokokë koagulazë pozitive, Ngarkesë mezofile).

Për vitin 2021 prevalenca e rezultateve të rasteve pozitive mbi normë sipas legjislacionit në fuqi është 2.85 % ose (32/1121) kampion (Tabela 5).

Tabela 5. Numri i mostrave sipas kategorive (planeve të monitorimit, kontrolleve zyrtare dhe autokontrollit) si dhe numri i mostrave mbi normë)

Nr.	Kategoritë e analizave	Matricat	Mostra të pranuar	% e realizimit të mostave	Mostra mbi normë	% mbi normë
1	Plani i Monitorimit të Molusqeve Bivalvë (PKM-Molusqe)	Molusqe bivalvë të gjallë	77	100%	6	7.8 %
		Ujë lagune	4	100%	0	0.0%
2	Kontrolle nga AKU	Mish, qumësht, prodhime ujore dhe nënprodukte	677	100%	26	3.8%
3	Autokontroll/Eksporte	Mish, qumësht, prodhime ujore dhe nënprodukte	363	100%	0	0.0%
Totali			1121		32	2.85%

Në tabelën 6 janë paraqitur rastet pozitive të kampioneve të ardhura në kuadër të kontrollit zyrtar. Shihet që kjo prevalencë është më e madhe krahasuar me vitin 2020.

Tabela 6. Trendi i prevalenës (%) së rasteve pozitive për kampionet zyrtare

Kontrolli Zyrtar (AKU)	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
Totali kampioneve	1711	2010	1473	888	1121
Totali raste pozitive	41	103	44	14	26
Trendi në %	2,40%	5,12%	2,99%	1,58%	2,33%

Ky sektor i përgjigjet vlerësimin mikrobiologjik, sezonalitetit të ndotjes duke mbështetur klasifikimin e zonave të prodhimit për treguesin *E.coli* në 100 g moluks bivalvë. Për këtë qëllim, bazuar në rezultatet e marra del që 6 kampione nga 77 kamione molusk i gjallë rezultojnë mbi normen 230 MPN/100g (Tabela 5).

Përsa i përket zbulimit të mikroorganizmave patogjene në raport me matricat e analizuar, në total gjatë vitit 2021 u konstatuan 14 kampione të ndotur me *Salmonella* spp tek pasta e pulës; dy kampione me *Salmonella* në mishin e pulës; u rikonfirmuan si pozitive kampionet e ardhur për *Salmonella* dhe Enterobakterie nga AKU DRQ. Kemi patur dy raste me

Enterobakterieve në akullore, një rast me E.coli në djathë dhe një rast në gjalpë. Nuk kemi patur asnjë rast me *Listeria monocytogenes*. Nuk ka ardhur asnjë kampion për *Cronobacter sakazakii* dhe qeliza somatike.

Shpërndarja e rasteve pozitive në matrica të ndryshme të gjithë aktivitet analitik të laboratorit paraqitet në figurën 4.




Figura 4: Shpërndarja e rasteve pozitive sipas matricave

AKTIVITETE TEKNIKO-SHKENCORE

- ✓ Takimi i 11-të specifik mbi Rrjetin Shkencor AMR mbi të dhënat e monitorimit të zoonozave - 9-10 nëntor 2020 - WEB – IPA.
- ✓ Takimi i 39-të i Rrjetit Shkencor për të dhënat e monitorimit të Zoonozave – IPA
- ✓ Punëtorja EURL-Campylobacter – Takimi online
- ✓ 9th BfR-Summer Academy 2021 – Seria e Leksioneve
- ✓ Programi 26th EURL-Salmonella Workshop 2021, RIVM (WEB)

AKREDITIMI

Ky sektor mirëmban rregullisht 10 metoda të akredituara me Entin Kombëtar të Akreditimit (DPA) sipas ISO 17025:2017 si më poshtë:

- *NUMËRIMI I STAPHYLOCOCCUS KOAGULAZË (+) – TEKNIKA E NUMËRIMIT NË PJATË (Metodë e Normuar ISO 6888-1: 1999/Amd1: 2003)*
- *ZBULIMI I SALMONELLA SPP. NË USHQIME DHE USHQIMET E KAFSHËVE (Metode e Normuar ISO 6579-1:2017)*
- *NUMËRIMI I ESCHERICHIA COLI B-GLUKURONIDAZË-POSITIVE (NPM) (Metode e Normuar ISO/TS 16649-3: 2015(E))*
- *NUMËRIMI I E. COLI B-GLUKURONIDAZË-POSITIVE NË PJATË (Metode e Normuar ISO/TS 16649-2:2001)*
- *ZBULIMI I L. MONOCYTOGENES NË USHQIME DHE USHQIMET E KAFSHËVE (Metode e Normuar ISO 11290-1:2017)*
- *NUMËRIMI I ENTEROBAKTERIEVE NË PJATË (Metode e Normuar ISO 21528-2:2017)*
- *NUMËRIMI I MIKROORGANIZMAVE NË USHQIME DHE USHQIMET E KAFSHËVE, TEKNIKA E NUMËRIMIT TË KOLONIVE NË 30°C (Metode e Normuar ISO 4833-1: 2013)*
- *NUMËRIMI I LISTERIA MONOCYTOGENES – TEKNIKA NË PJATË (Metode e Normuar PA PARAMETRA VALIDIMI ISO 11290-2:2017)*
- *NUMËRIMI I BACILLUS CEREUS I DYSHIMTË -TEKNIKA E NUMËRIMIT NË PJATË NË 30 OC (Metode e Normuar ME PARAMETRA VALIDIMI ISO 7932: 2004)*
- *SEROTIPIZIMI I SALMONELLA SPP. (Metode e Normuar PA PARAMETRA VALIDIMI)*

PJESËMARRJA NË TESTET E ZOTËSISË

Për garantim të cilësisë së rezultateve për provat e tjera objekt validimi/akreditimi, gjatë vitit 2021, specialistët e sektorit kanë marrë pjesë gjithësej në 27 teste zotësie organizuar nga PHE-FEPTU. Rezultatet e testeve kanë qenë të kënaqshme.

OBJEKTIVAT

Objektivat e reaslikuara për vitin 2021 janë si më poshtë:

1. Mirëmbajtja e akreditimit për të gjitha provat e akredituara me trupër Shqipëtare të Akreditimit, DPA.

2. Analizimi i kampioneve të ardhur në kuadër të Planeve Kombëtare të Monitorimit të Molusqeve bivalvë.
3. Analizimi i kampioneve të ardhur në kuadër të planit me bazë Risku të AKU-së dhe kontrolleve zyrtare
4. Analizimi i kampioneve të ardhur në kuadër të autokontrollit dhe eksporteve.

PROBLEMATIKA

- ✓ Mungesën e identifikimit me kod ID/kod alfanumerik të mostrave të ardhura nga PKM me bazë risku AKU (duhet dërguar informacion ZPK-së që të gjithë inspektorët e AKU-së të shënojnë në kllapa kategorinë e mostrës që i referojen planit.
- ✓ Mungesa e kiteve të amplifikimit për të realizuar aktivitetet zhvillimore e për metodat e *E.coli* O157 dhe *Clostridium botulinum* për vitin 2021.
- ✓ Ndarjen e dhomës së ekstraktimit nga dhoma e përgatitjes së mastermiksit.
- ✓ Buxhetimi i Autoriteti Kompetent i Planit me Bazë Risku të AKU-së për realizimin e tij në lidhje me kërkesat e analizave fiziko-kimike si dhe të produkteve të peshkimit (si histaminë dhe TVB-N).
- ✓ Buxhetimi i aktivitetit të laboratorit të Referencës në përmbushjen e detyrave si laborator reference në lidhje me trajnimin dhe organizimin e testeve paralele të mostrave të standardizuara me laboratorët e AKU-së.

Raport vjetor DSHK 2021

Mbi aktivitetin analitik të Laboratorëve Testues (LT) të Departamentit të Shëndetit të Kafshëve (DSHK), Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë

Përgatitur nga :

Jonida Boci; Nën/Drejtor; Departamenti I Shëndetit të Kafshëve (DSHK)

Ani Vodica; Përgjegjëse; Sektori i Diagnozës (DSHK)

Arla Juma; Përgjegjëse; Sektori i Serologjisë (DSHK)

Valentin Shtjefni; Përgjegjës; Sektori i Patologjisë (DSHK)

DEPARTAMENTI I SHËNDETIT TË KAFSHËVE (DSHK)

Departamenti i Shëndetit të Kafshëve ka si aktivitet bazë përcaktimin e shkakut të sëmundshmërisë ose ngordhshmërisë së specieve të ndryshme të kafshëve dhe e mbështet punën mbi **Ligjin 10465 “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë”**.


Ky Departament ka në strukturën e tij 13 laboratorë diagnostik për sëmundjet virale, bakteriale dhe parazitare me një staf prej **18** punonjësish.

Ai ofron ofron shërbime të specializuara për diagnostikimin e sëmundjeve në kafshë dhe shpendë bazuar në kuadrin ligjor të veterinarisë.

Gjatë vitit 2021 laboratorët e DSHK kanë analizuar në total **3836** kampionë me **16651** analiza (Tabela 1).

Tabela 1: Numri i analizave dhe kampioneve analizuar nga laboratorët e DSHK

	Sektori I Diagnozes		Sektori I Serologjise		Sektori I Patologjisë	
	Kampione	Analiza	Kampione	Analiza	Kampione	Analiza
Plane	137	241				
Zyrtare	59	59				
Autokontroll	297	806				
Totali	493	1106				



SEKTORI I DIAGNOZËS

Sektori i Diagnozës në Kafshë dhe Shpendë ka si aktivitet bazë diagnostikimin e sëmundjeve bakteriale, virale dhe parazitare në specie dhe matrica të ndryshme. Sektori mbulon diagnozën complete të sëmundjeve në kafshë nëpërmjet izolimit dhe identifikimit të agjentit shkaktar në veçanti si dhe nëpërmjet metodave molekulare.

Sektori zbaton planet kombëtare të monitorimit të sëmundjeve të kafshëve si më poshtë:

- Planet Kombëtare të monitorimit dhe kontrollit të sëmundjeve, (FMD, Blue Tongue, CSF, AI).
- Programet e strategjive që lidhen me eradikimin e sëmundjeve zoonotike (Anthrax Bruceloze, TBC).

- Planet e monitorimit post-vaksinal si Bruceloze REV 1 ne te Imta, Terbimi ne dhelqren e kuqe.
- Kontrollet zyrtare lidhur me përcaktimin e shkakut të sëmundshmërisë ose ngordhshmërisë së specieve të ndryshme në kafshë, në shpendë dhe akuakulturë bazuar. Ligji Nr. 10465 datë 29.09.2011 “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë”.
- Plani për marrjen e mostrave në kuadër të kontrollit zyrtar mbi prodhimin dhe tregtimin e produkteve të peshkimit nr. Prot 2236 dt. 08.03.2019.

Në strukturën e Sektorit përfshihen: **Laboratori i Bakteriologjisë së Përgjithshme** fokusi kryesor i të cilit është diagnostikimi i mastiteve dhe patogjenëve të tjerë mikrobik si dhe përcaktimi antibiotiko-rezistencës për shkaktarët e mastiteve si dhe diagnostikimi i sëmundjeve të tjera bakteriale; **Laboratori i Zoonozave Bakteriale** në të cilin diagnostikohen sëmundjet me rëndësi zoonotike si Plasja, Salmonella, Kolibakteriozat, Streptokokët, Stafilokokët etj si dhe evidentimi i rezistencës antimikrobike; **Laboratori i Parazitologjisë dhe Entomologjisë** në të cilin diagnostikohen sëmundjet parazitare të kafshëve dhe shpendëve, endo dhe ektoparazitë, parazitët e gjakut, diferencimi i vektorëve me rëndësi veterinarë për trasmetimin e Vector Borne Diseases si dhe kryerja e analizave për parazitin zoonotik Anisakis sipas Planit të monitorimit të MBZHRAU me provë të Akredituar; **Laboratori i Biologjisë Molekulare** në të cilin kryhen analizat e sëmundjes së Dermatozës Nodulare, Peste de Petit ruminants, Tuberkulozit etj me anë të Real Time PCR; **Laboratori i Linjave Qelizore** në të cilin kryhen izolime të viruseve të ndryshme si Terbimi, Murtaja, Gjuha Blu etj si teknika Gold Standart; **Laboratori i TBC** në të cilin vendoset diagnoza për një ka sëmundjet më të rëndësishme zoonotike atë të Tuberkulozit me anë të metodave Gold Standart.

Metodat që përdoren në këtë sektor janë metodat që përdoren në Laboratorët e Referencës së BE-së dhe që bazohen në Manualin e OIE-së (<https://www.oie.int/en/home/>).

Prova e identifikimit të Anisakis në produkte iktike është provë e akredituar dhe procedura e përdorur është bazuar në: “*Directive 2006/88/EC, on animal health requirements for aquaculture animals and products thereof, and on the prevention and control of certain diseases in aquatic animals*”.

AKTIVITETI LABORATORIK

Gjatë vitit 2021 sektori i Diagnozës ka kryer gjithsej 1116 analiza në **493** kampione (Tab. 1), të ardhur në kuadër të Planeve të monitorimit, kontrolleve zyrtare si dhe autokontrollet.

Tabela 1: Analizat e kryera në bazë të laboratorëve

Laboratori	Shkaktarët	Nr. i kampioneve	Nr. i kampioneve mbi normë	Nr. i analizave
Laboratori i Bakteriologjisë së Përgjithshme	Mastite	89	89	267
	Bakteriale e përgjithshme	35	35	105
Laboratori i Zoonozave Bakteriale	Antrax	70	16	156
	Zoonoza bakteriale	116	116	348
Laboratori i Parazitologjisë dhe Entomologjisë	Parazitare e Përgjithshme	14	12	28
	Parazitare bletë	29	29	58
	Anisakis spp	60	0	60
Laboratori i Biologjisë Molekulare	Influcë aviare	59	31	59
	TBC	4	3	4
Laboratori i Linjave Qelizore	Terbimi	10	8	10
Laboratori i TBC	Tuberkuloz	7	6	21
TOTALI:		493		1116


Sipas kategorive të kontrollit: janë kryer 300 (26.8%) analiza zyrtare (Plane monitorimi dhe Kontrolle Zyrtare) nga 1116 analiza gjithsej; ndërsa për autokontrollet janë kryer 806 (72.2%) analiza. Të dhënat tregojnë se puna e Sektorit në aspektin laboratorik mbështetet më shumë në mostrat e ardhura nga Autokontrollet.

Tabela 2: Kampionet dhe analizat e kryera

Llojet e analizës	Numri i kampioneve	Përqindja sipas totalit të kampioneve të Sektorit	Numri i analizave	Përqindja sipas totalit të analizave të Sektorit
Analiza bakteriale të përgjithshme dhe Mastite	124	25.1%	372	33.3%
Analiza bakteriale zoonotike	116	23.5%	348	31.1%
Antrax	70	14.1%	156	6.27%
Analiza parazitare	103	20.8%	146	13.0%
TBC	7	1.41%	21	1.88%
Analiza Biologji molekulare	63	12.7%	63	5.6%
Analiza linja qelizore	10	2.02%	10	0.89%
Totali	493		1116	

Fig. 1: Analizat e kryera në përqindje sipas kategorive të kontrollit për vitin 2021

Fig. 1 Analizat e kryera sipas fushes se operimit 2021



Në lidhje me kampionet e rezultuara pozitiv (alertet) gjatë vitit 2021 u konstatuan 16 raste pozitive me Antrax, 6 raste pozitive me TBC dhe 31 raste pozitive Influcë aviare. Bazuar në Urdhërin Nr. 24 datë 30.01.2013 “Për unifikimin e procedurave, metodave dhe dokumentacionit të funksionimit të laboratoreve”, ISUV për çdo rast njofton me anë të sistemit “ALERT” dhe me shkresë zyrtare AKU dhe MBZHR.

OBJEKTIVAT

Për vitit 2021, sektori ka realizuar këto objektiva si më poshtë:

1. Mirëmbajtja e akreditimit për testn e akredituar: “Zbulimi i larvave të Anisakis në peshk dhe nënproduktet e tij”
2. Realizimin e Planeve Kombëtare të Monitorimit. Janë realizuar të gjitha planet për të gjithë kampionet e ardhur në ISUV.
3. Zhvillimi i metodave të reja:

ZBULIMI I MURTAJËS AFRIKANE TË DERRIT ME METODËN E REAL-TIME PCR

ZBULIMI I INFLUENCES AVIARE ME METODËN E REAL-TIME PCR

ZBULIMI I PESTES SE RUMINANTEVE TE VEGJEL ME METODËN E REAL-TIME PCR

ZBULIMI I TUBERKULOZIT ME METODËN E REAL-TIME PCR

ZBULIMI I DERMATOZES NODULARE ME METODËN E REAL-TIME PCR

4. Puna në të gjithë Departamentin ka vazhduar sipas Menaxhimit të Cilësisë në zbatim të ISO 17025 për të garantuar besueshmërinë, cilësinë e të dhënave si dhe dokumentimin e tyre.

AKTIVITETE TEKNIKO-SHKENCORE DHE AKREDITIMI

AKREDITIMI

Është mirëmbajtur akreditimi për 5 metoda me trupën Shqipëtare të Akreditimit (DPA). Gjatë vizitës vlerësuese në laboratorët e këtij sektori nuk u gjet asnjë jo konformitet. Gjatë vitit 2021 në lidhje me menaxhimin e cilësisë janë rishikuar Proçedura Operative Standarte si dhe Proçedura Menaxhuese Standarte për mbarëvajtjen e punës në sektor. Janë plotësuar të gjithë dokumntacionet në cilësi në lidhje me menaxhimin e aparaturave, ambjenteve, monitorimin e temperaturave të frigoriferëve, jo konformiteteve etj.

SEKTORI I SERLOGJISË

Sektori i Serologjisë ka si aktivitet bazë diagnozën serologjike të sëmundjeve bakteriale, virale dhe parazitare në specie të ndryshme kafshesh për matricen gjak dhe qumësht. Sektori mbulon diagnozën serologjike të sëmundjeve në kafshë dhe shpendë nëpërmjet identifikimit të antitropave dhe përfshihet në monitorime kombëtare që realizohen plotësisht në laboratorët e sektorit. Gjithashtu sektori kontribuon në proceset e vaksinimit që aplikohen sipas udhëzimeve të Ministrisë së Bujqësisë duke vërtetuar praninë e antitropave në kafshët dhe shpendët e vaksinuar.

Sektori i Serologjisë në strukturën e tij ka 3 Laboratore:

- 1. Laboratori i Serologjisë për Sëmundjet Bakteriale dhe Parazitare**
fokusi kryesor i të cilit është diagnoza serologjike e sëmundjeve bakteriale dhe parazitare.

2. **Laboratori i Serologjisë për Sëmundjet Virale në shpendë** fokusi kryesor i të cilit është diagnoza serologjike e sëmundjeve virale në shpendë.
3. **Laboratori i Serologjisë për Sëmundjet Virale në kafshë** fokusi kryesor i të cilit është diagnoza serologjike e sëmundjeve virale në kafshë.

Gjatë vitit 2021 janë kryer gjithsej 19217 analiza ku përfshihen kontrollet zyrtare, autokontrollet dhe planet e monitorimit kombëtar. Rezultatet e kampioneve e konfirmuara pozitive sipas Legjislacionit në fuqi përcillen menjëherë në Sektorin e Mirëqënies së Kafshëve të MBZHR dhe AKU sipas formatit; Njoftime të Menjëhershme/Alerte Bazuar në Urdhërin Nr. 24 datë 30.01.2013 “Për unifikimin e procedurave, metodave dhe dokumentacionit të funksionimit të laboratoreve”, ISUV për çdo rast njofton me anë të sistemit “ALERT” dhe me shkresë zyrtare AKU dhe MBZHR.

Sektori është përfshirë edhe gjatë 2021 në kontrolle zyrtare, autokontrolle dhe procese monitorimi të nivelit kombëtar por edhe të nivelit lokal, pas izolimit të mëparshëm të shkaktarit të sëmundjes.

Monitorimi kombëtar i Brucelozës në të gjithë fermat e qumështit të gjedhit Republikës së Shqipërisë me numër krerësh me shume se 5 dhe monitorimi i anitrapave vaksinale pas vaksinimit me vaksinen REV1 në fermat e selektuara të të imëtave në Republikën e Shqipërisë ka qenë punë voluminoze e sektorit.

Përfshirja në plane monitorime kombëtare dhe lokale ka qenë kontribut në monitorimin dhe konfirmimin e disa sëmundjeve virale për vitin 2021.

Monitorimi i CAEV, Maedi Visnae, Blue Tongue, Afta epizootike, Terbimi, Influenca avjare gjithashtu kanë qenë pjesë e punës voluminoze të sektorit.

Tabelë 1: Situata në lidhje me kontrollet zyrtare, autokontrollet gjatë vitit 2021

	Nr kampioneve	Nr analizave	Nr i Rasteve Pozitive (krere) /Alerte

<i>Sektori i Serologjise</i>	298	532	<i>Bruceloza , Aborte dhe Shendetesime</i>	12
	1	1	<i>Leishmanioza</i>	
	206	206	<i>Influenca avjare Autokontroll</i>	5
	453	353	<i>Pseudopest Autokontroll</i>	15
	46	46	<i>Leukoza Enzotike e Gjedhit (EBL)</i>	26

SITUATA NE LIDHJE ME PLANET E MONITORIMET PER PERIUDHEN

JANAR-DHJETOR 2021

MONITORIME KOMBETARE					
	Plan monitorimi	Akti komunitar (Ligji ku mbeshtetemi)	Nr I analizave	Nr I Rasteve Pozitive /Alerte	
			Nr I kampioneve/ ferma		
Semundja					
<i>Bruceloza gjedh,qumesht igrumbulluar</i>	Plan monitorimi Kombetar	Mbështetur në Ligjin Nr. 10465, datë 29.09.2011 "Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, neni 129, gërma "b", miratohet strategjia e mëposhtme, e Kontrollit të Brucelozës në Gjedh.	10458 ferma	10702	21
Bruceloza gjedh ndivduale (gjak)	Plan monitorimi Kombetar	Mbështetur në Ligjin Nr. 10465, datë 29.09.2011 "Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, neni 129, gërma "b", miratohet strategjia e mëposhtme, e Kontrollit të Brucelozës në Gjedh.	825	1035	54
<i>Bruceloza (dele dhe dhi) REV1 Monitorim pas vaksinimit</i>	Plan monitorimi Kombetar	Ligji 10465 "Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë"	3074	3074	
Influenca Aviare, shpende	Plan monitorimi Kombetar	Ligji 10465 "Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë"	968	968	16
<i>Maedi Visnae ne dhen (MV)</i>	Plan monitorimi Kombetar	Ligji 10465 "Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë"	341	348	134

<i>CAEV , dhi</i>	Plan monitorimi Kombetar	Ligji 10465 “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë”	396	396	123
<i>Blue Tongue</i>	Plan monitorimi Kombetar	Ligji 10465 “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë”	348	402	133
<i>AFTA Epizootike</i>	Plan monitorimi Kombetar	Ligji 10465 “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë”	373	746	
<i>Terbimi/Ab</i>	Plan monitorimi Kombetar	Ligji 10465 “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë”	270	270	80
<i>Terbimi/TZT, IF</i>	Plan monitorimi Kombetar	Ligji 10465 “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë”	267	267	174
<i>Terbimi/IF</i>	Plan monitorimi Kombetar	Ligji 10465 “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë”	267	267	

Keshtu rezultatet per semundjen Bruceloze tregojne prezence ne fermat e medha te qumeshti ne gjedh. U identifikuan 21 ferma pas monitorimit te qumeshtit. Numeri i krereve te identifikuara pozitive gjate testimeve individuale pas rezultateve pozitive te qumeshtit arriti 54 krere pozitive ne qarqet Kukës, Lushnjë, Fier, Gjirokaster, Korçë, Berat, Diber, Lezha Ne sektor monitorohen gjithashtu per antitropa brucelare abortet dy deri tre jave pasi ka ndodhur aborti.

U konfirmuan antitropa brucelare pas aborteve ne 19 krere ne 6 ferma ne qarqet Gjirokastra , Vlora, Kukës. Pas konfirmimit te aborteve jane testuar kreret e mbetur per te bere shendetesim te tufave. Disa here eshte mberritur statusi Negative Bruceloze ne keto ferma.

Ne kuadrin e monitorimit të sëmundjeve virale së CAEV dhe MV rezultatet serologjike treguan prezence ne disa qarqe per CAEV dhe prezence te Maedi Visnae ne Shkoder, Diber, Tirane, Elbasan.

Monitorimi të sëmundjes së BLV(Leukozës së Gjedhit), nga kampionet e testuar kane treguar prezence ne nje ferme te Durrësit.

Testimet serologjike nuk ka treguar prezence per FMD e gjedhit dhe kane vertetuar prezence per Blue Tongue ne rrethet Fier, Diber, Gjirokaster, Vlore.

Autokontrollet jane kerkuar nga komplekset e shpendeve per monitorim te antitropave vaksinale dhe identifikim antitropash per semundje virale.

Kete vit Influenca avjare pas disa vitesh mungese u identifikua ne shpende ne rrethet Tropoje, Tirane, Mat e me vone vone sektori u perfshi ne monitorim kombetar per kete semundje qe u identifikua dhe ne rrethet Tropoje, Tirane, Mat, Pogradec, Shkoder, Elbasan.

Menaxhimi i Cilësisë

Në mënyrë të vazhdueshme është komunikuar me Departamentin e Menaxhimit të Cilësisë për plotësimin e kërkesave të standardit ISO/IEC 17025:2017 dhe është punuar për marrje akreditimi, mirembajtje akreditimi dhe validim metodash.

- Kete vit u mor Akreditim per tre teste serogjike ne diagnozen e semundjeve virale ne kafshe.
 - ELISA per FMD
 - ELISA per CSF
 - ELISA per Rabies

- Jane mirembajtur procedurat e riakredituara per diagnozen e Brucelozes
 - Testi Fiksimit te Komplementit per diagnozen e Brucelozës,
 - Testi Aglutinimit te Shpejte per diagnozen e Brucelozes,
 - Testi i Aglutinimit te Ngadaltë për diagnozën e Brucelozes
 - Testi ELISA per diagnozen e Brucelozës

- Janë rishikuar Procedurat Operative Standarde
 - Testi ELISA per semundjen e Gumboros
 - Testi ELISA per semundjen e Bronkitit
 - Testit ELISA Ab (IgM) per diagnozen e WN

- Jane parashikuar per akreditime
 - ELISA per Influcencën Aviare në shpendë
 - Reaksioni i HA dhe HAP per Influcencën Aviare në shpendë
 - Reaksioni i agar xhel imunodifuzionit(AGID) per Influcencës Aviare në shpendë
 - Testi IELISA per diagnozen e Brucelozes, qumesht

- Testi IFT, Rabies

Eshte vazhduar me demonstrimin e cilesise nga labororet duke validuar metodat për të gjithë parametrat, Riprodhueshmeri, Riperseritshmeri, Sensitivitet dhe Specificitet.

Ne kuader te cilesise u aplikuan Kartat e kontrollit per te gjithë testet serologjike te perdorura ne tre labororet.

Gjithmone hyrja ne procedurat e validimit dhe akreditimi vijne pas testeve te aftesimit te cilat sektori i ka marre pas bashkepunimeve serioze me rezultate te kenaqeshme me labororet e References te Bashkimit Evropian.

(EU Reference Laboratories)

Nr.	Testet	Enti Organizues	Mirembajtje/Akreditim /Proces akreditimi
1	Testi Fiksimit te Komplementit per diagnozen e Brucelozes	ANSES, OIE Brucellosis Reference Center	Mirembajtje
2	Testi Aglutinimit te Shpejte per diagnozen e Brucelozes	ANSES, OIE Brucellosis Reference Center	Mirembajtje
3	Testi I Aglutinimit te Ngadalte per diagnozen e Brucelozes	ANSES, OIE Brucellosis Reference Center	Mirembajtje
4	Testi IELISA per diagnozen e Brucelozes, gjak	ANSES, OIE Brucellosis Reference Center	Mirembajtje
5	Testi IELISA per diagnozen e Brucelozes, qumesht	ANSES, OIE Brucellosis Reference Center	Proces akreditimi
6	FMD	ANSES	Akreditim
7	CSF	Institute of Virology Hanover	Akreditim
8	Rabies ELISA	ANSES	Akreditim

9	Rabies IFT	ANSES	Proces akreditimi
10	Influenca Aviare testet: HI,AGP , ELISA	GD Animal Health,Hollande	Proces akreditimi

Pjesëmarrje në Trainime

Kete vit Sektori ne nivel ekspertesh u perfshi ne trajnimin;

Improving and Enhancing National Capabilities for Early Detection of Vector Borne Diseases through the Application of Conventional and Molecular Methods (Project Ref. ALB5008)

me objektiv kryesor prodhimin e standardeve te brendeshme duke ju pershtatur kerkesave te OIE per validimin te teknikave diagnostike per te treguar cilesise ne Sektor.

SEKTORI I PATOLOGJISË

Sektori i **Patologjisë** ka si aktivitet bazë përcaktimin e shkakut të sëmundshmërisë ose ngordhshmërisë së specieve të ndryshme të kafshëve dhe e mbështet punën mbi **Ligjin 10465 “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë”**.

Kuadri ligjor ku janë mbështetur praktikat laboratorike të Departamentit

Nr.	Kuadri ligjor
1	Ligji Nr. 10465 datë 29.09.2011 “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë”.

Puna e përditshme përfshin 3 kategori kontrollesh: **Plane monitorimi, Kontrolle zyrtare dhe Autokontrolle**. Metodatat që përdoren për vendosjen e diagnozës janë metoda të normuara që përshtaten në shqip nga Manuali i OIE-së dhe metoda të marra nga Laboratorët e Referencës së BE-së, në disa raste përdoren metoda të brendëshme të orientuara sipas rregullore të BE-së. Metodatat janë të miratuara nga Departamenti i Menaxhimit të Cilësisë bazuar ISO17025.

Pjesë e punës së përditshme të Departamentit është përmirësimi i vazhdueshëm i punës nëpërmjet zhvillimit dhe përditësimit të teknikave të reja të analizimit, pjesëmarrja në Teste

Proefiçence, ndjekjen e udhëzimeve të MBZHR si dhe të Laboratorëve të Referencës me të cilat bashkëpunon çdo Laborator, përgatitja e dokumentacioneve të ndryshme, pritja dhe përpunimi i kampioneve, plotësimi i regjistrave të Menaxhimit të Cilësisë, përgatitja e Raporteve të Provës, përlllogaritja e kërkesave dhe buxhetit, plotësimi i formateve dhe dokumentacioneve të ndryshme.

I. **Spektori i Patologjisë** ka si aktivitet bazë përcaktimin e shkakut të sëmundshmërisë ose vdekshmërisë së specieve të ndryshme të kafshëve.

Në këtë Sektor bëjnë pjesë: **Zyra e Pritjes së Kampioneve** ku kampionet konform për analizë pranohen, regjistrohen, plotësohen formatet përkatëse dhe shpërndahen në laboratorët përkatës. Gjaë këtij viti kanë ardhur një numër kampionesh që i korrespondon një kodi progresiv prej 11618, kod i cili krahasur me atë të një viti më parë prej 3918, është rreth tre here më i lartë .

Laboratori i Nekropsisë funksioni kryesor i të cilit është përcaktimi i shkakut të ngordhjes ose sëmundshmërisë nëpërmjet kryerjes së nekropsisë dhe duke u bazuar në ndryshimet morfopatologjike diagnoza orientohet në laboratorët përkatës. Gjatë këtij viti janë realizuar në total 482 nekropsi në kafshë dhe shpend të ndryshme të cialt janë detajuar në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Emërtimi	Nr.i kafshëve	Përçindja
1	Dhelpra	270	56,01%
2	Dhen	10	2,07%
3	Dele	5	1,03%
4	Qen	5	1,03%
5	Gic	1	0,2%
6	Viça	3	0,62%
7	Lepuj të butë	6	1,24%
8	Shpendë	182	37,77%
9	Totali	482	100,00%

Laboratori i Histopatologjisë ka si funksion vendosjen e diagnozës me anë të metodave dhe ngjyimeve histologjike, gjatë këtij viti janë realizuar vetem 9(nëntë) teste, 1(një) viç dhe 8(tetë) zogjë pule, të cilët të gjithë kanë rezultuar pozitiv për sëmundjen Marek.

Laboratori i Tërbimit i financuar nga Projekti “Paza”, në kuadrin e monitorimit të të vaksinimit kundër tërbimit, që përfshin periudhën e kater mujorit të parë të vitit 2021 për dhelprat të cilat janë vaksinuar në periudhën e vjeshtës 2020, ka realizuar të gjitha testet. Laboratori kryen disa teste: Testi i Imunofluoeshencës, Testi i zbulimit të Tetraciklinës (TZT), Testi i zbulimit të antitropave (ELISA) nga gjaku dhe letrat e filtrit. Testet e kryera, janë pasqyruar në tabeën e mëposhtme.

Në Sektor janë kryer gjithsej 1296 analiza, kampionet e konfirmuara pozitive sipas Legjislacionit ne fuqi përcillen menjëherë në Sektorin e Mirëqënies së Kafshëve të MBZHR dhe AKU.

Tabela 1: Numeriku i analizave realizuar gjatë muajve Janar-Dhjetor 2021

Sektorët Analitikë	Numri i analizave	Numri i Rasteve Pozitive/Alerte
Sektori i Patologjisë		
Lab. Nekropsisë	482	-
Lab. Histopatologjisë	9	8
Lab. Iktiopatologjisë	-	-
Lab. Tërbimit ELISA Ab (post/vaksinal)	270	80
Lab. Tërbimit TZTetraciklines (post/vaksinal)	267	174
Lab. Tërbimit IFT	268	-
Totali	1296	262

Njoftime të Menjëhershme/Alerte

Bazuar në Urdhërin Nr. 24 datë 30.01.2013 “Për unifikimin e procedurave, metodave dhe dokumentacionit të funksionimit të laboratoreve”, ISUV për çdo rast njofton me anë të sistemit “ALERT” dhe me shkresë zyrtare AKU dhe MBZHR.

Bashkepunimi me Institucione te tjera

Bashkëpunimi me MBZHR, AKU, AKSH, FMV dhe Institucione jashtë vendit

Stafi i Departamentit të Shëndetit të Kafshëve ka bashkëpunuar me:

FMV, në kuadrin e bashkëpunimit sipas kontratës së nënshkruar përfshihen pjesë të stafit në dhënin e praktikave Laboratorike në fusha të ndryshme.

Në këtë kuader është botuar një artikull Gjermani për sëmundjen e Leukozës.

Bashkëpunime me Institucione/Projekte Ndërkombëtare:

Pjesëmarrje në Teste proefiçence

Eshtë marrë pjesë në tre teste të proficencës për sëmundjen e Terbimit, konkretisht në IFT, RTCIT dhe ELISA Ab (post/vaksinal). Rezultati për IFT test ka qenë në përputhje të plotë me laboratorin e referencës. Për dy testet e tjera nuk është kthyer përgjigje.

Pjesëmarrje në Trainime Wrokshope

Eshtë marrë pjesë në një trajnim online për teknikat e validimit të sëmundjeve virale.

“Virtual Training on validation of serological techniques for viral diseases

8 – 14 December 2021”

Menaxhimi i Cilësisë

Vazhdon puna për validimin e metodës së diagnozës me anën e IFT, për sëmundjen e Terbimit. Është rishikuar një POS dhe është bërë një POS i ri po për këtë sëmundje.

Aktivitete të tjera

DSHK ka zhvilluar aktivitete të lidhura me ndarjen e buxhetit, dërgimin për ofertë të nevojave, analizën vjetore të DSHK-së dhe konkretizim të planeve të punës në secilin Sektor. Në kuadër të procedurave të prokurimit Publik përmendim: përgatitjen e Procedurave të Prokurimit, DST, zbatim i Urdhërave për tenderat e planifikuar për vitin 2021.

Aktivitete të tjera të përditshme përfshijnë:

Përditësimin e Listës së Shërbimeve.

Problematika të lidhura me Sistemin

Problematikë vazhdon të mbetet mungesa e ardhjes së kampioneve lidhur me Planet e Monitorimit nga Shërbimi Veterinar problem që sjell mos realizimin e planeve dhe mos përdorimin e kiteve dhe reagenteve.

Vonesa në REALIZIMET E e Proçedurave të Prokurimit Publik të zërave si Kite, Reagente, Terrene-Suplementë dhe Standarte.

Raport vjetor DTMM 2021

Mbi aktivitetin analitik të Laboratorëve Testues (LT) të Departamentit të Toksikologjise Monitorimit te Mbetjeve dhe Kontrollit te Medikamenteve Veterinare(DTMMKMV), Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë

Përgatitur nga :

Elmira Marku; Departamenti I Toksikologjise Monitorimit te Mbetjeve, Kontrollit te Barnave (DTMMKB)

Suzana Kola ; Përgjegjëse; Sektori i Toksikologjise monitorimit te Mbetjeve (STM)

Elida Palluqi; Përgjegjëse; Sektori i Kontrollit te Medikamenteve Veterinare (KMV)

Sektori i Toksikologjisë dhe Mbetjeve ka në organikën e tij 4 laboratorë:

- Laboratori i Medikamenteve Veterinare
- Laboratori i Metaleve të Rënda
- Laboratori i pesticideve në produktet me origjinë shtazore
- Laboratori i Mykotoksinave, një laborator i ri pranë këtij sektori i cili funksionet e tij i ka kryer në kushte jo të përshtatshme ndaj ka nevojë për mbështetje në krijimin e ambjenteve të reja optimale për këtë qëllim specifik, pajisjen me aparatura ndihmëse si dhe një staf teknik të lartë të dedikuar për këtë qëllim.

MISIONI

Misioni i Sektorit të Toksikologjisë dhe Mbetjeve është identifikimi i përdorimit të paligjshëm të substancave të ndaluara në prodhimin shtazor, abuzimin me produktet mjekësore veterinare të autorizuara, kontrollin e kontaminatëve si dhe garantimin e implementimit të procedurave të duhura, në shërbim të mbrojtjes së shëndetit të njerëzve dhe interesave të konsumatorit.

QËLLIMI

- Duhet të garantojë zbatimin me korrektësi të detyrave që ky sektor ka.

- Duhet të garantojë performancë dhe besueshmëri të analizave që kryhen në këta laboratorë.
- Përditësimin e metodikave laboratorike.
- Zhvillimin e metodave të reja me qëllim rritjen e kapaciteteve analitike.
- Validimi i metodave të reja me qëllim rritjen e performancës analitike.

METODOLOGJIA

Metodologjia e përdorur në analizat e kryera bazohet në rregulloret e përditësuara të BE si dhe metodikat e Laboratorëve të Referencës të BE-së të cilët kanë të njëjtin aktivitet analitik. Paisjet matëse të përdorura për qëllimin e caktuar janë të një teknologjie dhe ndjeshmërie të lartë si:

- Kromatografi e lëngët (HPLC-DAD/FLUO dhe LCMS-MS),
- Kromatografi egaztë (GC-MS/MS)
- Spektrofotometri (ICP/MS dhe AAS)

PËRMBLEDHJE

Gjatë vitit 2021 aktiviteti laboratorik në këtë njësi administrative është kryer në kushte që nuk kanë qenë të përshtatshme dhe optimale për të realizuar objektivat, për shkak të punimeve që janë kryer në laboratorët e këtij sektori. Kjo situatë u karakterizua me shumë të papritura e me zhvillime pune të diktura nga kjo situatë, e që ndryshonin në çdo kohë.

Çështjet e marrëdhënieve të punës dhe ato të sigurisë dhe shëndetit në punë, janë ndërthurur duke patur ndikim të ndërsjelltë tek njëra tjetra sepse kryerja e një pune të denjë, fillon nga formalizimi i një marrëdhënie në punë e deri tek kushtet e sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës, për çdo punonjës. Ky vit ka shënuar edhe numrin më të lartë të problematikave, e ku çdo rast, është ndjekur, trajtuar, zgjidhur e adresuar në kohë.

Gjatë Vitit 2021 në sektor është punuar në disa drejtime. Është punuar në realizimin e analizave në kuadër të Planeve të Monitorimit dhe të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, në planifikimet e buxheteve për nevojat e laboratorëve, në hartimin e Planit Kombëtar të Mbetjeve, në komisionë të vlerësimeve të ofertave, në grupe pune për shtrimin e metodikave të reja me qëllim rritjen e kapaciteteve laboratorike dhe uljen e numrit të kampioneve të nënkontraktuara, në trajnime të brëndshme nga staf i specializuar me qëllim përmirësimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore.

Organizimi i punës në këtë peiudhë të vështirë, është realizuar përmes takimeve diskutimeve, shpërndarjes së punës, punës në grup, në mënyrë që objektivat e përcaktuara për këtë sektor të realizohen. Është dërguar informacion periodik duke bashkëpunuar në mënyrë të vazhdueshme me Përgjegjësën e Departamentit për arritjen e rezultateve të punës së përbashkët. Janë zgjidhur probleme komplekse që dalin gjatë punës së tij, që kanë lidhje me realizimin e analizave, procedurave analitike, procedurave menaxhuese.

Me një staf prej 6 specialistësh dhe 2 laborantë në kohë të plotë dhe tre laborantë me kontratë (të atashuar në sektor në mes të vitit) janë realizuar:

- Per PKM-2021 kanë 2043 kampione, dhe janë kryer 9900 analiza për 69311 (Tabela 1).
- Per Planit të Monitorimit të Peshkut, kane ardhur 90 kampione dhe janë kryer 90 analiza (Tabela 2)
- Per Planit të Monitorimit të Molusqeve, kane ardhur 32 kampione dhe janë kryer 24 analiza (Tabela 3)
- Per Autoritetin kombëtar të ushqimit (AKU) kane ardhur 96 kampione dhe janë kryer 185 analiza (Tabela 4)

Janë zhvilluar metodat e reja me pajisje instrumentale LC/MS-MS si më poshtë:

- Grupi i madh i Antibiotikëve (nga 17 substanca që ka kërkesa plani ky numër është rritur në 38 substanca) në matricat qumësht dhe muskul për analizimin e 729 kampioneve dhe 27702 përcaktimeve
- Grupi i hormoneve me efekt anabolik (Stilbenet) për analizimin e 38 kampione/114 përcaktimeve.

AKTIVITETI ANALITIK

Në vijim një analizë e aktivitetit analitik në kuadër të detyrave kryesore të punës në këtë sektor që kanë të bëjnë me shërbimet ndaj institucioneve publike (MBZHR, AKU).

- **Plani Kombëtar i Monitorimit të Mbetjeve bazuar në Urdhër Nr. 149 datë 09.04.2021 me Nr. 2702/2 Prot**

Ka si qëllim kontrollin dhe monitorimin e mbetjeve të medikamenteve veterinarë në produktet me origjinë shtazore janë rregulluar nga direktiva e Këshillit Europian 96/23/EC, e


cila pasqyron kërkesat që duhet të plotësohen për planifikimin dhe ekzekutimin e planeve kombëtare të mbetjeve për kafshët e gjalla dhe për produktet me origjinë shtazore.

Substancat e përfshira në këtë plan ndahen në dy kategori kryesore:

- Grupi A: liston substancat që kanë efekt anabolik dhe substancat e paautorizuara; Stilbenet/Tirostatikët/Steroidët/Laktonët e acidit Rezociklik /B-agonistët / Substancat e ndaluara si Nitrofuranët/Kloramfenikol dhe Nitroimidazolet
- Grupi B: përmban listën e medikamenteve veterinarë dhe ndotësve, që autorizohen për përdorim në kafshët për prodhim ushqimor Antibakterialët/ Antihelmetikët/ Antikoksidialët/ Sedativët/ Karbamate dhe Piretroidë/ Pesticidet/ Metalet e Rënda/ Mykotoksinat/ Ngjyruesit

Për periudhën 22 Janar-23 Dhjetor kanë ardhur 2058 kampione nga të cilat :

- 15 kampione nuk kanë përmbushur kriteret e pranimit të mostrave, nuk janë analizuar,
- 37 kampione kanë ardhur si ndjekje të rasteve mbi normë të shpallura për PKM-2020 dhe janë analizuar
- 16 kampione kanë ardhur si ndjekje të rasteve mbi normë të shpallura për PKM-2021 dhe janë analizuar
- 1990 janë kampione të ardhura për realizimin e PKM-2021 dhe janë analizuar




Grafiku Nr. 1. Ecuria e ardhjes së kampioneve në kuadër të PKM-së, sipas muajve

Referuar tabelës së mëposhtme në lidhje me ardhjen e kampioneve si dhe analizave të ardhura dhe të kryera të shpërndarë sipas muajve kemi një realizim prej 100% përsa i përket kampioneve, 100 % përsa i përket analizave.

Tabela 1: Shpërndarja e kampion/analizave dhe realizimi i tyre sipas muajve

Aktiviteti Analitik	Nr. kampioneve të Ardhura	Nr. kampioneve të Realizuara	Nr.Analizave të Ardhura	Nr.Analizave të kryera	Nr. përcaktimeve të kryera
Janar	65		465		
Shkurt	128	1	879	1	2
Mars	153	17	884	17	5
Prill	134	45	1024	44	515
Maj	208	307	916	1973	4538
Qershor	240	102	1249	341	2516
Korrik	190	379	733	1034	2937
Gusht	174	115	788	890	4316
Shtator	219	269	788	785	8237
Tetor	217	105	914	194	2369
Nentor	211	42	776	732	9836
Dhjetor	104	176	484	395	3284
Janar 2022		154		725	3819
Shkurt 2022		331		2767	26937
Totali	2043	2043	9900	9900	69311



Grafiku Nr. 2. Ecuria e kryerjes së analizave në kuadër të PKM-së.

Duke parë këtë grafik shohim një analizim të pakët gjatë 4 muajve të parë të kampion/analizave.

Kjo ka ardhur për shkak të vonesave të kiteve, dhe ardhja e tyre në sasi të limituar. Këto pengesa sollën grumbullimin e kampioneve që u rezultua me mosanalizim në kohë të tyre. Analizimi me kite ka filluar në muajin Maj.

Gjithashtu shihet një rënie në muajin tetor-nëntor e cila ka ardhur për shkak të zhvendosjes së laboratorëve pas restaurimit të pjesshëm të tyre. Për shkak të kësaj zhvendosjeje kampionet do të mblidhen (kampionet priten të vijnë deri më 31 dhjetor) dhe analizimi i tyre përfundon brenda 15 Shkurtit 2022 kohë e cila tregon dhe afatin e mbylljes së analizimit të PKM-së.

Janë kryer një numër prej 681 analizash, përfshirë dhe konfirmimin e 79 rasteve jo-konform, me nënkontraktim në Laboratorin e Referencës Cer GROUP bazuar në Marrëveshjen me Nr. 499 Prot të datës 17.06.2020 që ISUV ka bërë me të.

➤ **Plani për marrjen e mostrave në kuadër të kontrollit zyrtar mbi prodhimin dhe tregtimin e produkteve të peshkimit.**

Analizat në kuadër të këtij Plani bazohen në “Plani për marrjen e mostrave në kuadër të kontrollit zyrtar mbi prodhimin dhe tregtimin e produkteve të peshkimit Nr. Prot 2236 dt. 08.03.2019 dhe kryhen vetëm për pesticidet/PCB-të. Në kuadër të tij kanë ardhur 90kampione për 90 analiza dhe janë kryer 90 kampione/90 analiza për 2340 përcaktime.

Realizimi është në masën 100% për kampion/analizë, erdhi si pasojë e zhvendosjes së laboratorëve , e cila solli pengesë në mosvënien në punë të aparaturës matëse GC-MS/MS (mungesë e linjës së gazeve në laboratorët e restauruar).

Tabela 2: Numri I kampion/analizave në kuadër të PMP, gjatë muajve Janar-Dhjetor 2021,

Aktiviteti Analitik	Nr. kampioneve të Ardhura	Nr. Kampioneve të Realizuara	Nr. Analizave të Ardhura	Nr. Analizave të kryera	Nr. Përcaktimeve të kryera
Janar	4	0	4	0	0
Shkurt	8	0	8	0	0
Mars	5	0	5	0	0
Prill	5	14	5	14	364
Maj	7	0	7	0	0
Qershor	7	0	7	0	0
Korrik	8	24	8	24	624
Gusht	9	0	9	0	0
Shtator	8	15	8	15	390
Tetor	9	9	9	9	234

Nëntor	10	0	10	0	0
Dhjetor	10	0	10	0	0
Janar 2022					
Shkurt 2022		28		28	728
Totali	90	90	90	90	2340

➤ **Planet e kampionimit të zonës së rritjes dhe mbledhjes së molusqeve bivalvë të gjalla**

Planet e kampionimit të zonës së rritjes dhe mbledhjes së molusqeve bivalve të gjalla,

- BM1: Laguna e Butrintit, Sarandë (Nr. 1412 Prot., datë 28/03/2013; Nr. 1587 Prot., datë 7/03/2014);
- Gjiri i Shëngjinit, (Nr. 5119/2 Prot., datë 28/8/2014);
- Gjiri I Butrintit, në Ksamil, Sarandë, Qarku Vlorë (Nr. 9658 Prot., datë 15/12/2015) dhe në zonat natyrale të bregdetit Shqiptar (zonën Karavasta MB5, Shkumbin – Spille MB6,
- Gjiri I Durrësit BM7 dhe Shëngjin-Velipojë BM8; Nr. prot. 77, Datë 10/01/2017, Kepi I Rodonit, Deti Adriatik (Nr. 2875/1 Prot., datë 31/07/2018).

Tabela 3: Numri i kampion/analizave në kuadër të PMM, gjatë muajve Janar-Dhjetor 2021.

Molusqe				
Zona e kampionimit	Nr.kampione të planifikuar	Nr.kampione të ardhura	Nr. analizash të kryera	Nr. i përcaktimeve të kryera
BM1		6	12	18
TOTAL		6	12	18
Ujë deti për metale të rënda				
BM1		13	-	-
TOTAL		13	-	-
Ujë deti për pesticide/PCB				
BM1		13	-	-
TOTAL		13	24	36

Mosrealizimi i disa prej analizave në kuadër të këtij plani ka ardhur si rezultat i mosvënies në punë të instrumentave.

➤ **Analizat e ardhura nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit**

Analizat që kryhen për AKU bazohen në Udhëzimin Nr. 3 të Ministrit datë 18.01.2021 I cili ka ardhur në ISUV më datë 14.04.2021 me Nr. 1417 Prot.

Në kuadër të tij kanë ardhur 96 kampion për 185 analizë dhe është kryer 185 analizë për 321 përcaktime.

Realizimi është në masën 100%

Tabela 4: Numri i kampion/analizave në kuadër të AKU, gjatë muajve Janar-Dhjetor 2021.

Aktiviteti Analitik	Nr.kampione ve të Ardhura	Nr.kampioneve të Realizuara	Nr.Analizave të Ardhura	Nr.Analizave të kryera	Nr. përcaktimeve të kryera
Janar	10	0	20	0	0
Shkurt	7	13	14	26	39
Mars	5	0	10	0	0
Prill	10	10	20	20	30
Maj	11	12	22	24	36
Qershor	10	8	19	15	25
Korrik	9	0	17	0	0
Gusht	8	1	16	1	45
Shtator	6	26	12	52	78
Tetor	3	0	6	0	0
Nentor	13	0	21	0	0
Dhjetor	5	0	8	1	0
Janar 2022					
Shkurt 2022		26		47	68
Totali	96	96	185	185	321

➤ Njoftime të Menjëhershme/Alerte

Bazuar në Urdhrin Nr. 24 datë 30.01.2013 “Për unifikimin e procedurave, metodave dhe dokumentacionit të funksionimit të laboratoreve” ISUV, për çdo rast, njoftohet me alert dhe me shkresë zyrtare AKU dhe MBZHR.

Informimi i shpejtë mbi rezultatet pozitive (alert) është një element i rëndësishëm në transmetimin e informacionit nga laboratorit në institucionet zbatuese të kontrollit, duke lejuar një identifikim të hershëm të potencialit të riskut.

Gjatë analizimit të kampion/analiza janë gjeneruar 39 kampione mbi normë për PKM-2021
 *37 kampionet e ardhura ne laborator si ndjekje të rasteve mbi normë të shpallura për PKM-2020, kanë rezultuar conform

Një tablo mbi shpërndarjen e tyre jepet në tabelën e mëposhtëm.


Tabela Nr. 5 Rastet pozitive/jokonform të gjeneruara gjatë analizimit të PKM-2021

Nr.	Muaji	Kodi I kampionit	Matrica	Analiza e kërkuar	Qarku	Rezultati i Provës
1	Prill	U319/2021	Qumësht lope	B2a (Antihelmetikët)	Dibër	JK për Ivermektinë
2		U643/2021	Qumësht dele	B2a (Antihelmetikët)	Berat	JK për Ivermektinë
3	Maj	U933/2021	Urinë dele	A3 (Steroidet)	Korçë	JK për 17-Beta Testosterone
4		U935/2021	Mjalt	B1 (Antibakterialet)	Korçë	JK për Streptomycin
5		U1192/2021	Urinë dele	A3 (Steroidet)	Elbasan	JK për 17-Alpha Nortestosterone
6	Qershor	U1848/2021	Urinë dele	A3 (Steroidet)	Elbasan	JK për 17-Alpha Nortestosterone
7		U1618/2021	Urinë dele	A3 (Steroidet)	Dibër	JK për 17-Alpha Nortestosterone
8		U315/2021	Veze	B1 (Antibakterialet)	Durrës	JK për Enrofloxacin+Ciprofloxacin
9		U2024/2021	Qumësht dhie	B2e(Antiinflamatoret jo - Steroidal)	Korçë	JK për Acidin Salicilik
10	Qershor	U2055/2021	Qumësht dhie	B2e(Antiinflamatoret jo - Steroidal)	Dibër	JK për Acidin Salicilik
11	Korrik	U541/2021	Qumësht lope	B2a (Antihelmetikët)	Kukës	JK për ABZ-Aminosulfon ABZ- Sulfoxid ABZ- Sulfon
12	Tetor	U3021/2021	Mjalt	B1 (Antibakterialet)	Gjirokastrë	JK për Tylosin
13		U3024/2021				

14		U2706/2021			Berat	JK për Tetracycline+epi- tetracycline
15		U2743/2021			Shkodër	
16		U3253/2021			Kukës	
17		U2804/2021			Lezhë	
18		U1641/2021	Vezë	B2b (Antikoksidialët)	Tiranë	JK për Maduramycinë/ Salinomycinë
19		U4516/2021	Plazëm dhie	A6 (Substancat e ndaluara)	Elbasan	JK për 4 methyl aminoantypyrine (marker residue metamizol)
20		U2088/2021	Vezë	B2b (Antikoksidialët)	Tiranë	JK për Maduramycinë
21		U1867/2021	Vezë	B1 (Antibakterialët)	Fier	JK për Enrofloksacinë
22		U3449/2021	Mjalt	B1 (Antibakterialët)	Tiranë	JK për Tetracycline+epi- tetracycline
23	Tetor	U3474/2021	Vezë	B1 (Antibakterialët)	Durrës	JK për Enrofloksacinë /Ciprofloksacinë
24	Nëntor	U3253/2021	Mjalt	B1 (Antibakterialët)	Kukës	JK për Streptomycin
25		U3253/2021	Mjalt	B1 (Antibakterialët)	Kukës	JK për Streptomycin
26		U3852/2021	Mjalt	B1 (Antibakterialët)	Korçë	JK për Streptomycin
27		U3853/2021	Mjalt	B1 (Antibakterialët)	Korçë	JK për Streptomycin
28	Janar 2022	937/2021	urine dele	A3 (Steroidet)	Korçë	JK për 17-Alpha Nortestosterone
29		1457/2021	urine derri	A3 (Steroidet)	Shkodër	JK për 17-Beta Nortestosterone
30		2800/2021	urine derri	A3 (Steroidet)	Lezhë	JK për 17-Beta Nortestosterone
31	Shkurt 2022	4161/2021	Mjalt	B1 (Antibakterialet)	Fier	JK për Tetracycline+epi- tetracycline
32		6866/2021	Urine	A3 (Steroidet)	Durrës	JK për 17-Alpha Nortestosterone
33		4601/2021	Veshkë dele	B3c(Metalet e rënda)	Kukës	JK për Cadmium
34		5438/2021	Veshkë dele		Gjirokastrë	

35		5442/2021	Veshkë dele		Gjirokastrë	
36		5979/2021	Veshkë dele		Tiranë	
37		6500/2021	Veshkë dele		Shkodër	
38		5687/2021	Veze	B3a (klororganiket dhe PCB)	Elbasan	JK për DDT
39		5707/2021	Dhjame dhie	B3B(fosfororgan iket)	Elbasan	JK për chlorpyrifos

Nisur nga tabela e mësipërme, jepet një informacion në lidhje me numrin e përcaktimeve të gjetur jo konform për çdo qark.



Grafiku Nr. 3. Ecuria e rasteve jokonform sipas qarqeve.

PROBLEMATIKA

Sektori i Toksikologjisë dhe Mbetjeve gjatë vitit 2021 ka hasur një sërë problematikash në lidhje me realizimin e kampion/analizave në kuadër të Planit Kombëtar të Mbetjeve:

1. Mosardhja në kohë e Planit të Monitorimit të Mbetjeve.
2. Sasitë e limituara dhe mungesa e disa kiteve kanë sjellë mos realizim të disa kampion/analizave e cila ndikoi direkt në rritjen e nënkontraktimeve.
3. Analizimi me ELISA ka filluar në muajin maj për shkak të ardhjes me vonesë të kiteve.
4. Sasia e kiteve të ardhura gjatë vitit 2021 është e pamjaftueshme për analizimin e të gjitha kampioneve të PKM 2021 e cila solli grumbullimin e kampioneve dhe dhënien e përgjigjes në një afat më të vonshëm.
5. Ardhja e disa standarteve në dhjetor të vitit 2021 ka penguar zhvillimin e metodave të reja.
6. Kushtet e papërshtatshme kanë sjellë vështirësi në zhvillimin e analizave kimike pasi pajisjet matëse nuk plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- Instrumenti nuk duhet të jetë i ekspozuar direkt në dritën e diellit.
 - Në ambientin ku qëndron instrumenti të mos ketë pluhur dhe rrjedhje gazi.
 - Instrumenti nuk duhet të jetë afër rrymave të ajrit, burimeve të nxehtësisë dhe kondicionerit.
 - Temperatura e ambientit duhet të jetë 18-28 °C.
 - Ambienti duhet të jetë i ventiluar. I aspiruar dhe I kondicionuar
 - Duhet të ketë të instaluar linjën e gazeve,
7. Transferimi gjatë muajit tetor detyroi sektorin të bllokojë kryerjen e analizave ndërkohë që pritja e kampioneve ka vazhduar rregullisht sipas planeve të inspektimit duke çuar në grumbullimin e tyre.
 8. Probleme me procedurat doganore lidhur me dërgimin e kampioneve me nënkontraktim pengoi analizimin në kohë.
 9. Mungesa gjatë vitit të pajisjeve instrumentale për të përballuar gamën e gjerë të përcaktimeve analitike ishte një pengesë, [instrumenti LC-MS/MS ka ardhur në dhjetor 2021].
 10. Asistencë teknike të jashtme në çdo kohë për të rritur efikasitetin e përdorimit të aparaturave pasi realizimi i procedurave të tenderit sjell vonesa në realizim të planeve

OBJEKTIVAT

Gjatë vitit 2021 janë zhvilluar metodat e reja me pajisje instrumentale LC/MS-MS si më poshtë:

- Zhvillimi i metodës së përcaktimit të Antibiotikëve (nga **17** substanca që ka kërkesa plani ky numër është rritur në **38** substanca) në matricat qumësht dhe muskul.
- Zhvillimi i metodës së hormoneve me efekt anabolik (Stilbenet) për analizimin e tyre në matricën urinë.
- Riakreditimi i metodës së Aflatoxinës M1 në qumësht (lope, dele, dhie) me HPLC-FLD
- Riakreditimi i metodës së pesticideve në qumësht dhe vezë me GC-MS/MS për 24 përcaktime

Për vitin 2022 sektori ka planifikuar si më poshtë:

- Zhvillimi i metodës së përcaktimit të hormoneve
- Planifikimi për akreditim i testeve për përcaktimin e metaleve të rënda (plumb dhe kadmium) në produktet e peshkimit (peshk, krustace, cefalospod dhe molusqe) me ICP-MS.

- Planifikimi për akreditim i testeve për përcaktimin e mërkurit në produktet e peshkimit (peshk, krustace, cefalospod dhe molusqe) me CV-AAS.

Raport vjetor DMC 2021

Mbi aktivitetin e *Departamenti I Menaxhimit te Cilesise Pranimit te Kampioneve dhe Vivariumit*

Përgatitur nga :

Pellumb Aleksii: Departamenti I Menaxhimit te Cilesise Pranimit te Kampioneve dhe Vivariumit
Denada Telo ; Përgjegjëse; Sektori i Menaxhimit te Cilesise dhe Pranimit te Kampioneve

AKTIVITETI I DEPARTAMENTIT TË MENAXHIMIT TË CILËSISË PRANIMIT
TË KAMPIONEVE DHE VIVARIUMIT


Departamentit Menaxhimit të Cilësisë Pranimit të Kampioneve dhe Vivariumit është i ndarë në 2 sektorë: Sektori i Menaxhimit të Cilësisë dhe Sektori i Pranimit të Kampioneve dhe Vivariumit. Në përbërje të Sektorit Menaxhimit të Cilësisë është Laboratori i Metrologjisë dhe Laboratori i Preparatorisë Speciale. Sektori tjetër ushtron aktivitetin në Pranimin e Kampioneve dhe Mbarështimin e Kafshëve të Laboratorit. Personeli i departamentit është i përbërë prej një stafi prej 13 punonjesh, 8 të lartë dhe 5 të mesëm.

Bazuar në objektivat e paracaktuara, janë ndjekur një sërë aktivitetesh të cilat kanë bërë të mundur identifikimin e pikave të dobta dhe të forta të laboratorëve me qëllim përmirësimin e aktivitetit laboratorik dhe zgjerimin e testeve të akredituar në ISUV.

Objektiv madhor i vitit 2021 ka qenë ruajtja e akreditimit dhe zgjerimi i tij në laboratorë të Diagnozës Veterinare dhe Mikrobiologjisë Ushqimore sipas standardit të rishikuar ISO 17025:2017. Rrjedhimisht, është punuar në mënyrë intensive për përmirësimin e aktiviteteve me qëllim përfaqjen e tyre me kërkesat e Standardit ISO 17025 dhe kërkesat e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit.

Aktualisht i gjithë aktiviteti i Departamentit është i përmbledhur në një numër të madh dokumentash të cilët aplikohen detyrimisht në të gjithë laboratorët e akredituar dhe objekt akreditimi (Grafiku 1).

Grafiku 1. Dokumentacioni total sipas Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë (SMC)



Për të gjithë Laboratorë ku është shtrirë Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë është verifikuar e gjithë gjurmueshmëria e proceseve nga pranimi i kampionëve deri në nxjerrjen e raportit të provës dhe pas veprimeve të kryera janë marrë të gjitha masat për përmirësimin e aktiviteteve referuar kërkesave.

Në këtë kuadër në mënyrë të vazhdueshme është komunikuar me Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit për plotësimin e kërkesave të kësaj Drejtorie për mirëmbajtjen dhe zgjerimin e Akreditimit.

Kështu është punuar mbi këto çështje:

- Vlerësimi i dosjeve të validimit sipas kërkesave të menaxhimit;
- Dosja e Pajisjeve;
- Dosja e Personelit;
- Dosja e Sigurimit të Cilësisë së të dhënave.

Për këtë janë kryer verifikime për evidentimin e problematikave, janë rishikuar procese, janë zhvilluar takime informuese me qëllim përmirësimin e aktiviteteve.

Si pasojë e verifikimeve/aktiviteteve të kryera janë azhurnuar një sërë dokumentash të cilat pasqyrojnë veprimet e ndërmarra:

Tabela 1 Dokumentacioni i hartuar dhe/ose rishikuar gjatë vitit 2021

Procedura Menaxhuese	Dokumenta Organizativ	Procedura Operative	Udhëzues	Procedura të validuara	Modulistika/formularë
7	2	43	1	1	47

ARRITJA E OBJEKTIVAVE TË DEPARTAMENTIT

Bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë e këtij Departamenti, aktiviteti i kryer gjatë vitit 2021 ka qënë i orientuar në këto drejtime:

1. Aplikimi i kërkesave të standardit ISO 17025:2017 në laboratorët e ISUV-së;
2. Ruajtja e akreditimit dhe zgjerimi sipas objektivave institucionale, referuar standardit të ri ISO 17025:2017;
3. Kryerja e kalibrimeve të brendshme të pajisjeve matëse;
4. Përgatitja e terreneve kulturore për laboratorët që operojnë në fushën e Mikrobiologjisë Ushqimore dhe Diagnozës Veterinare;
5. Pranimi Qëndror i Kampioneve;
6. Mbarështimi i kafshëve laboratorike, të cilat shërbejnë për kryerjen e testeve biologjike në ISUV.

Objektivi 1. Aplikimi i kërkesave të standardit ISO 17025:2017 në laboratorët e ISUV-së


Me rishikimin e standardit ISO 17025 janë rishikuar një sërë procesesh përshkak të përjasjes me kërkesat e reja. Gjatë vitit 2021 të gjitha aktivitetet teknike dhe menaxhuese që janë ndryshuar janë reflektuar në ndryshimin e dokumentave që i përshkruajnë këto aktivitete (Grafiku 2).

Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë i krijuar konform kërkesave të ISO 17025:2017 dhe i dokumentuar në 807 dokumenta, është i shtrirë në nivele të ndryshme, në laboratorë të ndryshëm. Kjo për shkak se kosto, si në burime njerëzore, furnizime dhe infrastrukturë, është më e lartë në laboratorë që punojnë sipas këtij sistemi. Deri më sot është operuar që dokumentat e Sistemit të Menaxhimit të jenë të detyrueshme për laboratorët e akredituar ose objekt akreditimi. Pas tyre vijnë laboratorët që janë objekt inspektimi nga FVO dhe sipas prioriteteve institucionale punohet me laboratorët e tjerë.

Rekordet që duhet të mbahen nga ana e laboratorëve, referuar procedurave të Sistemit, janë rreth 420 regjistrime (numër ky i varjueshëm sipas aktivitetit analitik). Për testet e akredituara dhe validuara ky sistem është i gjurmueshëm në të gjitha hallkat e aktivitetit laboratorik.

Duke qënë se ISUV ka një larmishmëri aktivitetsh, Sistemi i Menaxhimit është i organizuar me nga një përfaqësues në çdo Sektor, *Referent Cilësie*, i cili ndjek dhe menaxhon aplikimin me korrektësi të kërkesave të Sistemit të Menaxhimit në laboratorët e Sektorit të tij.

Grafiku 2. Ecuria e hartim/rishikimit të dokumentacionit ndër vite



Objektivi 2. Ruajtja e Akreditimeve dhe Zgjerimi i Akreditimit për Laboratorët e ISUV-së

Strukturat e përfshira në akreditim ose objekt akreditimi, me të cilat është punuar për menaxhimin e tyre në funksionin të garantimit të kërkesave për akreditim janë: 4 Departamente (përfshirë dhe Dep. Menaxhimit të Cilësisë), 10 Sektorë dhe 14 Laboratorë.

Menaxhimi i Cilësisë, u angazhua për përmirësimin e vazhdueshëm në funksionin të plotësisht të kërkesave të standardit ISO 17025 dhe trupave Akredituese si dhe Identifikimin e Pikave Kritike përgjatë aktiviteteve të laboratorëve testues, të cilat mund të çënonin Sistemin e Menaxhimit si rrjedhojë dhe ruajtjen e akreditimit. Për të realizuar këtë objektivi janë kryer verifikime të dokumentave referuar ndryshimeve në Referencat Normative; janë koordinuar aktivitetet për mbylljen e sygjërimeve të lëna nga Vizitat Mbikqyrëse të Trupave Akredituese; janë verifikuar proceset nëpërmjet Kontrolleve të brendshme.

Kështu, veprimet e ndërmarra për këtë qëllim konsistuan në: rishikimin e një sërë aktivitetsh të cilat më pas u pasqyruan në rishikime të dokumentave.

Në muajin korrik 2021, është kryer auditimi nga trupa inspektuese me 3 vlerësues të DPA-së për riakreditim dhe zgjerim referuar standardit të ri S SH EN ISO/IEC 17025:2017. Target kanë qenë 96 teste nga të cilat 3 akreditime të reja.

Si rezultat i kësaj pune intensive me të gjithë stafin e përfshirë, në 12 tetor 2021 pranë ISUV-së u akordua Çertifikata e Akreditimit sipas së cilit u arrit statusi i akredituar për 96 teste sipas standardit ISO 17025:2017.

Tabela 2. Numri i testeve të akredituara 2021


Nr	Teknika	Nr. testeve/matricave
----	---------	-----------------------

1	Mikrobiologjike	80
2	Serologjike	7
3	Kimike Instrumentale	4
4	Biologjike	1
5	Mikroskopike	2
6	Fiziko kimike	2
	TOTALI	96

Aktualisht, laboratorë e **Mikrobiologjisë Ushqimore** aplikojnë 24 Procedura Operative Standarde (POS) nga të cilat 21 janë të normuara dhe 2 të brendshme. POS të validuara janë 11 dhe të akredituara 10 (apo 80 teste).

Laboratorët e **Diagnozës Veterinare** aplikojnë 134 Procedura Operative Standarde (POS) nga të cilat 93 janë të normuara sipas manualit të OIE-së. Në total kanë 8 teste të akredituara, 7 serologjike dhe 1 mikroskopike. POS të validuara janë 9 në total, nga të cilat 8 serologjike janë dhe një mikroskopike.

Grafiku 3. Teste të akredituara ndër vite



Laboratorët e **Sektorit të Toksikologjisë** aplikojnë 55 Procedura Operative Standarde (POS) të gjitha metoda të brendshme (28 ELISA dhe 27 Instrumentale). Në total, janë 8 teste të validuara dhe 2 të akredituara.

Laboratorët e **Sektorit të Monitorimit të Peshkut dhe Molusqeve** aplikojnë 8 Procedura Operative Standarde (POS) nga të cilat 5 janë të normuara dhe 3 metoda të brendshme (2 Fiziko-kimike, 2 mikroskopike, 3 Instrumentale dhe 1 biologjike). Në total janë 5 teste të validuara dhe të akredituara.

Gjatë vitit sektori i menaxhimit ka verifikuar dhe përmirësuar aktivitetet teknike me qëllim zgjerimin e akreditimit në laboratorët e sipërpërmendur. Një objektiv i tillë u vendos dhe u mbështet bazuar në kapacitetet e laboratorëve, kërkesat e klientëve dhe sigurisht përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe rekomandimeve të ekspertëve të huaj. U punua konkretisht me verifikimin e Procedurave Operative dhe modulistikat përkatëse (Tabela 1), mbylljen e

dosjeve të validimit, dosjeve të personelit, dosjet e pajisjeve, menaxhimi i dokumentacionit, ambjentet janë përshtatur për të qënë sa më konform kërkesave të ISO 17025 sek.6.3. Janë kryer një sërë kalibrimesh dhe është trajnuar personeli për rëndësinë e dokumentacionit dhe veçanërisht atë të pajisjeve. I gjithë ky aktivitet ka qënë kryesisht i fokusuar sidomos në laboratorët diangostik që patën zgjerim akreditimi për tre teste.

Objektivi 3. Hartimi dhe zbatimi i planit vjetor të mirëmbajtjes së pajisjeve

Për realizimin e këtij objektivi nga Laboratori i Metrologjisë është kryer aktiviteti i mëposhtëm:

a) Kalibrimi i brendshëm i 68 sistemeve të përcaktimit të temperaturës.

Përshkrimi:

- Kryerja e procedurës së kalibrimit të sistemeve të përcaktimit të temperaturës
- Përpunimi statistikor i të dhënave të marra nga procedura e kalibrimit
- Përpilimi i raportit të kalibrimit, vlerësimi dhe shpërndarja e tij
- Plotësimi i dokumentacionit përkatës (module, skeda, etiketë) për instrumentin matës
- Shpjegimi i kriterëve të pranueshmërisë lidhur me pasigurinë në matje sipas indikacioneve të ISO 7218:2013 si dhe shpjegimi i intervaleve të pranueshmërisë të temperaturës të instrumenteve matës të temperaturës të vendosur në dhomat klimatike referuar vlerave të marra nga raporti i kalibrimit.

b) Kalibrimi i brendshëm i 23 peshoreve klasi I dhe II.

Përshkrimi:

- Kryerja e procedurës së kalibrimit për instrumentet e mësipërme
- Përpunimi statistikor në mënyrë manuale i të dhënave të marra nga kalibrimi i peshoreve
- Përpilimi i raporteve të kalibrimit, vlerësimi i tij dhe shpërndarja e tyre
- Plotësimi i dokumentacionit përkatës (module, skeda, etiketë) për instrumentet matëse.

c) Kalibrimi i 83 pipetave automatike një dhe shumëkanale.

Përshkrimi:

- Kryerja e procedurës së kalibrimit të pipetave automatike një dhe shumëkanale
- Leximi i rezultateve, nxjerrja e raportit të kalibrimit dhe vlerësimi.
- Shpërndarja e raportit të kalibrimit dhe plotësimi i dokumentacionit përkatës (module, skeda, etiketë) për instrumentet matëse
- Shpjegimi i raportit të kalibrimit.

d) Kontrolli i temperaturës/karakterizimi termik i 6 dhomave klimatike dhe vlerësimi i rezultateve referuar standardeve ndërkombëtare.

Përshkrimi:

- Kryerja e procedurës së kontrollit të temperaturës në të gjithë volumnin e dhomës klimatike
- Përpilimi i raportit të kontrollit, vlerësimi dhe shpërndarja e tij
- Plotësimi i dokumentacionit përkatës (module, skeda, etiketë) për pajisjen.

e) Verifikim i ndërmjetëm i 55 peshoreve (klasi II).

Përshkrimi:

- Kryerja e procedurës së verifikimit të ndërmjetëm
- Llogaritja e indeksit të pajtueshmërisë
- Plotësimi i dokumentacionit përkatës (module, skeda) për instrumentin matës.

f) Verifikim i ndërmjetëm i 67 pipetave automatike një dhe shumëkanale.

Përshkrimi:

- Kryerja e procedurës së verifikimit të ndërmjetëm të mikropipetave
- Përpilimi i raportit të verifikimit, vlerësimi dhe shpërndarja e tij
- Plotësimi i dokumentacionit përkatës (module, skeda, etiketë) për instrumentet matëse.

g) Verifikim i funksionimit i 6 pH-metrave.

Përshkrimi:

- Kryerja e procedurës së verifikimit të funksionimit të pH-metrave
- Përpilimi i raportit të verifikimit, vlerësimi dhe shpërndarja e tij
- Plotësimi i dokumentacionit përkatës (module, skeda) për instrumentet matëse.

h) Pasqyrimi i ndryshimeve që janë bërë në dokumentacionin përkatës.

Përshkrimi:

Është azhornuar mod.40-ME-006 lidhur mbi planin vjetor të mirëmbajtjes së pajisjeve.

i) Hartimi i planifikimit vjetor të mirëmbajtjes së pajisjeve (format Excel) për 4 Sektor, për 7 Laborator si dhe 2 të zyrës së Pritjes së Kampioneve.

Përshkrimi:

- Marrja në dorëzim dhe kontrolli i inventarit, dosjes së pajisjeve të laboratorëve në nivel sektori/laboratori
- Hartimi i planifikimit vjetor të mirëmbajtjes së pajisjeve referuar inventarit të pajisjeve
- Vendosja e formulave në formatin Excel të planifikimit vjetor referuar frekuencave të mirëmbajtjes së pajisjeve dhe konfirmimeve metrologjike
- Përfundimi i planifikimit të laboratorëve, dorëzimi i tij më pas hartimi i planifikimit vjetor të metrologjisë.

j) Zgjerimi i sistemit në fushën e Metrologjisë nëpërmjet përmirësimit të kapaciteteve dhe rritjes së besueshmërisë së rezultateve analitike, konkretisht për Laboratorin e Sëmundjeve Virale në Shpendë, kjo referuar ISO 17025.

Përshkrimi:

Janë kryer takime informuese dhe formuese si dhe është trajnuar personeli lidhur me menaxhimin/mirëmbajtjen e pajisjeve, procedurat dhe dokumentacionin përkatës të metrologjisë.

k) Asistencë laboratorëve ku është shtrirë metrologjia.

Përshkrimi:

- Janë asistuar laboratorët lidhur mbi dokumentacionin e pajisjeve dhe plotësimin e tyre, mirëmbajtjen, nevoja për shërbime kalibrimi si për pajisjet e reja dhe ato që janë në gjendje.

l) Është rishikuar 1 procedurë, 1 udhëzues dhe 2 module, pasi u shtuan guidat lidhur mbi vendosjen e kriterëve me qëllim vlerësimin e konformitetit të kampioneve primar.

Përshkrimi:

- Kërkim në internet mbi guidat, standardet dhe rregulloret kombëtare/ndërkombëtare etj.

- Shfrytëzim literature
- Pas shfrytëzimit të literaturave është hartuar dhe më pas miratuar procedura/modulet e mësipërme
- m) Raportimi i aktivitetit të laboratorit të Metrologjisë**
- Përpilimi i raporteve lidhur me aktivitetet e kryera nga ky laborator.

Tabela 3. Numri i instrumenteve matës të kontrolluar gjatë vitit 2021

Instrumenti matës	Shërbimi	Nr. i instrumenteve matës të kontrolluar
Pipetë automatike mono dhe multikanale	Kalibrim i brendshëm	83
Peshore teknike/analitike elektronike	Kalibrim i brendshëm	23
Termometër digjital min/max	Kalibrim i brendshëm	68
Inkubator, frigorifer	Karakterizim termik	6
Pipetë automatike mono dhe multikanale	Kontroll efijence	67
Peshore teknike/analitike elektronike	Kontroll efijence	55
pH-metër	Verifikim i funksionimit	6
TOTALI		308

Objektivi 4. Realizimi i prodhimit të terreneve kulturave në kohë dhe cilësi

Misioni i Preparatorisë Speciale është përgatitja e terreneve kulturore për kryerjen e analizave për laboratorët e kontrollit mikrobiologjik të ushqimit, shëndetit të kafshëve dhe kontrollit të medikamenteve veterinarë.

Në përputhje me kërkesat e laboratorëve ky Laborator ka prodhuar rreth 502 lote terrenesh kulturore, për nevojat e laboratorëve të ISUV-së, gjithashtu të gjitha proceset e kryera janë të dokumentuara në formularët përkatës (nga marrja e kërkesës për prodhim deri në dorëzimin e terreneve).

Objektivi 5. Menaxhimi i Kampioneve sipas Procedurave në fuqi

Përgjatë vitit 2021 në ISUV janë pranuar 6.900 kampionë për laboratorët e Sigurisë Ushqimore dhe 11.600 kampionë për laboratorët e diagnozës. Procedurat e pranimit, duke filluar nga verifikimet e fizike dhe të dokumentacionit që shoqëron kampionin e më pas regjistrimi, shpërndarja e tij në laborator dhe dorëzimi tek klienti të Raportit të provës janë kryer nga stafi i Zyrës së Pranimit të Kampioneve konformë kërkesave të Menaxhimit.

Për regjistrimin e kampioneve në Zyrën e Pranimit përdoret dhe një sistem digital i hedhjes së të dhënave, Lims, i ndarë në dy pjesë që funksionon në mënyrë të pavarur, një për Laboratorët e Shëndetit të Kafshëve dhe tjetri për Laboratorët që operojnë në fushën e Sigurisë Ushqimore.

Sistemi Lims vecanërisht për Sigurinë Ushqimore duhet të zhvillohet më tej si në kapacitet dhe në përmirësimin e të dhënave me qëllim lehtësimin e përdorimit të tij.

Objektivi 6. Mbarështimi i kafshëve eksperimentale në Vivarium

Mbarështimi i kafshë që përdoren nga laboratorë të ndryshëm të ISUV-së, në varësi të procedurave teknike. Menaxhimi i kafshëve eksperimentale në përputhje me standardet për mirëqenien e kafshëve referuar legjislacionit ka konsistuar në këtë aktivitet 2 herë në javë pastrim i përgjithshëm, një herë në javë remonti dhe çdo ditë pastrimi dhe ushqyerja e rreth 500 korrerëve (minj, lepuj, gjela dhe dashi) përfshirë trajtimin mjekësor sipas skemave të mjekimit dhe vaksinimit.

Problematikat 2021

Problematikat e ndeshura në përdorimin e sistemit LIMS në Zyrën e Pranimit të Kampioneve janë si më poshtë:

- Në regjistrimin e kampionëve hasen pengesa, për shkak të gabimeve që bejnë inspektorët në të dhënat që hedhin në Fletët e Shoqërimit të Kampionëve, përse ka të bëjë me kodin e fermës dhe/ose identifikimin e fermerit. Në këtë pikë Qarqet më problematike janë Korça dhe Vlora.
- Në sistemin Ruda nuk përputhen të dhënat e inspektorit për kodet e fermës me atë që kërkon sistemi psh. nga Inspektoriati i Vlorës për kampion peshk në Fletën e Shoqërimit kodi i fermës është një numër 4 shifror ndërkohe në Ruda pranohet kod 12 shifror.

- Shpesh herë haset bllokim i Sistemit Lims i cili sjell vonesa në regjistrimin e të dhënave.

Objektivat 2022

1. Zgjerimi i akreditimit për testin e Përcaktimit të mbetjeve të Pesticideve në Bimë (për një numër të konsiderueshëm matricash dhe analitësh) dhe akreditimi i testeve për diagnozën e Influcës Avjare në shpend.
2. Asistencë laboratorëve për ruajtjen e akreditimit;
3. Asistencë laboratorëve për përmirësimin e aktiviteteve teknike sipas kërkesave të Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë;
4. Realizimi planit vjetor të mirëmbajtjes së pajisjeve (shërbime të brendshme);
5. Menaxhimi i Kampioneve dhe prodhimi i terreneve kulturale sipas Procedurave në fuqi.
6. Mbarështimi i kafshëve eksperimentale në Vivarium.

Pika kritike për realizimin e objektivit për ruajtjen dhe zgjerimin e akreditimit:

1. Pjesëmarrja e suksesshme në Teste Zotësie;
2. Garantimi i mirëfunksionimit të pajisjeve nëpërmjet realizimit të servis-kalibrimeve;
3. Sigurimi i furniturave në kohë dhe cilësi sipas kërkesave të laboratorëve.